

“KUSHTET E PADREJTA NË KONTRATAT KONSUMATORE NË BASHKIMIN  
EUROPIAN SI DHE TANSPOZIMI I TYRE NË LEGJISLACIONIN  
SHQIPTAR, JURISPRUDENCA E GJED”

Punoi.Eva HAMITAJ

2017

“KUSHTET E PADREJTA NË KONTRATAT KONSUMATORE NË  
BASHKIMIN EUROPIAN SI DHE TANSPOZIMI I TYRE NË  
LEGJISLACIONIN SHQIPTAR, JURISPRUDENCA E GJED”

Punoi  
Av.Msc.Eva HAMITAJ

Tiranë 2017

KUSHTET E PADREJTA NË KONTRATAT KONSUMATORE NË BASHKIMIN  
EUROPIAN SI DHE TRANSPOZIMI I TYRE NË LEGJISLACIONIN  
SHQIPTAR, JURISPRUDENCA E GJED

*Abstrakt*

Revolucion industrial i cili i pati fillesat në gjysmën e dytë të shekullit të XVIII-të solli si pasojë zhvillimin e teknologjisë e cila lehtësoi së tepërmi jetesën duke krijuar premiset për të pasur edhe një zhvillim të theksuar në shumllojshmërinë e produkteve në treg, krahas këtij fakti një zhvillim të shpejt të konceptit të tregut e solli edhe teoria e Adam Smith (i cili njihet edhe si babai i ekonomisë politike) rreth rolit të shtetit në treg dhe faktit që konkurrenca ofron kushte më të favorshme të zhvillimit të ekonomisë duke vendosur rëndësinë tek zhvillimi i ekonomisë dhe jo tek thjeshtë ekzistenca e saj.

Domosdoshmërisht në kushtet e një zhvillimi të shpejtë të ekonomisë dhe tregut në tërësi lindi nevoja e mbrojtjes së konsumatorit i cili gjendur përball një tregu ku varjaconi i produkteve dhe krijimi i kushteve optimale të një tregu në konkurrencë, bënte që tregtarët të mund të kërkonin përfitimin më të lartë kjo edhe duke dëmtuar interesat e konsumatorëve kjo në një plan të shumfishtë, qoftë kjo shëndetsor ashtu edhe në atë ekonomik.

Duhet theksua se konsumatori është subjekti i fundit ku produkti testohet, dhe për pasojë mundësitë e dëmtimit janë të mëdha, kjo duke pasur parasysh faktin se ekonomia e tregut me themel konkurrencën jo të plotë krijon kushtet optimale për zhvillimin e vullneti për maksimizimin e fitimit shpesh jo në kushte të drejta, arsye për të cilën kërkohet garantimi institucional i të drejtave të konsumatorit në mënyrë që efektet e dëmshme të ambicjes tregtare për përfitim të mos dëmtojnë konsumatorin, por të mund që të shmaget abuzimi me funksionin e tregtarit të treg.

Në këtë kontekst edhe pse Bashkimi Europian që me firmosjen e traktateve të para të vendosura në themel të nevojës për satabilitet dhe zhvillim, dhe në prani të efekteve që do të sillnin katër liritë e garantuara me këto Traktate bënë present riskun përball së cilit do të ndodhesh konsumatori i cili tashmë nuk do të konsumonte vetëm produktet që mund të prodhoheshin fal industrisë vendase por do të ishte konsumator në kushtë të barabarta me çdo shtetas tjetër të BE-së dhe me një

varjacion produktesh të cilat vendin e origjinës e kishin të ndryshëm për produkte të ndryshme, kjo në vetëvete përbënte një risk jo vetëm për shëndetin e konsumatorit.

Në këtë punim është evidentuar garantimi i të drejtave ligjore të konsumatorit në mbrojtjen kundrejt kushteve të padrejta në planin komunitarë si dhe nevojshmëria për hartim dhe mirë zbatim të ligjit për mbrojtjen e konsumatorit në planin kombëtar kundrejt abuzimit nga ana e tregtarit në aplikimin e kusheve në dëm të tij, si dhe efektiviteti i rolit të institucioneve në garanimin e të drejtave të konsumatorit.

Qëllimi i këtij punimi është të trajtoj çështjet të cilat në praktikë kanë vështirësi për tu zgjidhur në kuadër të interpretimit në përputhje me frymën e Direktivës 93/13/KEE si dhe jurisprudencën e GJED-së, njëkohësisht të përcaktoj se si nëpërmjetë transpozimit dhe zbatimit të ligjit mund të përforcohet roli i konsumatorit në raport me tregtarin duke shmangur aplikimin e kushteve të padrejta në kontratat konsumatore.

Gjithashtu një vend të rëndësishëm në këtë punim do të kushtohet edhe rolit të institucioneve publike në garantimin mjaftueshëm të të drejtave të konsumatorit, si dhe roli i *gjobës* në përmirësimin e kontratave konsumatore, kjo duke respektuar të drejtat e tij të garantuara me ligj. Njëkohësisht ruajtjes së një balance mes përfitimit dhe nevojës ç'ka garantohet vetëm në raste të mirëfunksionimit të ligjit si dhe aplikim të çdo sanksioni të nevojshëm për shmangien e abuzimit dhe përfitimit në shkelje të të drejtave konsumatore.

Fjalët kyçe: *zhvillim industrial; maksimizim fitimi; garanci ligjore; gjobë; transpozim; balancë*

## **PËRMBAITJE**

Qëllimi ,objektivat ,metodologjia.....	8
--	---

### **KREU I**

#### **LINDJA DHE ZHVILLIMI I TË DREJTËS KONSUMATORE**

1.1.Lindja dhe zhvillimi i së drejtës së konsumatorëve.....	12
1.2.Kushtet e padrejta në kontratat konsumatore në legjislacionin shqiptarë.....	16
1.3.Aktet ndërkombëtare në mbrojtjen e konsumatorit kundrejt kushteve të padrejta.....	18
1.4.Politikat e mbrojtjes konsumatore kundrejt kushteve të padrejta.....	20
1.5.Nevojshmëria për mbrojtje konsumatore.....	21
1.6.Përgjegjësia e konsumatorëve në mbrojtjen nga kushtet e padrejta.....	24

### **KREU II**

#### **KUSHTET E PADREJTA NË KONTRATAT KONSUMATORE DHE VEPRIMTARIA INSTITUCIONALE**

2.1.Kuptimi i kontratave konsumatore ,dhe Direktiva 93/13/KEE.....	27
2.2.Analiza e kushteve të padrejta në kontratat konsumatore dhe Direktiva 93/13/KEE.....	31
2.2.1.Kushtet e padrejta nuk duhet të kenë qënë negociuar veçmas.....	33
2.2.2.Kushti është i padrejtë nëse shkakton pabarazi në të drejta dhe detyrime mes palësh në dëm të konsumatorëve.....	37
2.2.3.Mirëbësimi në kushtin e padrejtë kontraktual.....	41
2.3. Mbrojtja kundrejt kushteve të padrejta.....	45
2.4. Kushtet e padrejta shprehimisht të përcaktuara në ligj.....	48
2.5.Transparenca në kushtet kontraktore dhe Direktiva 93/13/KEE.....	49

2.6.Efektet juridike të kushtit të padrejtë në kontratat konsumatore,siaps Direktivës 93/13/KEE, dhe ligjit për mbrojtjen konsumatore.....	53
--	----

### **KREU III**

#### **INSTITUCIONET GARANTUSE TË SË DREJTËS SË KONSUMATORIT**

3.1.E drejta e ankimit të konsumatorit dhe parashikimi ligjorë.....	57
3.2.Institucionet garantuse të së drejtës së konsumatorit ,dhe praktika e tyre.....	58
3.3.Veprimtaria e Komisionit të mbrojtjes së konsumatorit në raport me kushtin e padrejtë.....	59

<b>Konkuluzone dhe rekomandime përfundimtare.....</b>	<b>61</b>
---	-----------

<b>BIBLIOGRAFIA.....</b>	<b>67</b>
--------------------------	-----------

*"...Konsumatori edhe pse grupimi më i  
madhë në ekonomi... janë i vetmi grupim i  
paorganizuar...me pikepamje shpesh të  
padëgjura..."*

*John F. Kennedy*

Ky studim është i hartuar në tre kapituj konkretisht:

Kapitulli i parë trajton hyrje në të drejtën e konsumatorit në tërësi dhe fillesat e mbrojtjes juridike të kushteve të padrejta në kontratat konsumatore ,duke evidentuar shkaqet të cilat krijuan kushtet e domosdoshme për mbrojtjen e konsumatorit kundrejt kushteve të padrejta,gjithashtu përcaktohet detyra e shteti për të garantuar jo vetëm parashikimin në akte komunitare dhe kombëtare por gjithashtu nevojshmërinë për të zbatuar këto akte kundrejt abuzimeve të tregtarit.

Kapitulli i dytë trajton në detaje kushtet juridike për t'u gjendur përball kushteve të padrejta në kontratat konsumatore,interpretimi i sakt juridik i këtyre kushteve,gjithashtu interpretimin që i ka dhënë GJED-së këtyre kushteve rast pas rasti,një rëndësi të veçantë paraqesin edhe efektet e pranisë së kushteve të padrejta në kontratat konsumatore,analiza kritike e këtyre efekteve ka nxjerë në pah nevojën për mbrojtje reale të konsumatorit kundrejt vullnetit të tregtarit për të maksimizuar fitimin.

Kapitulli tretë është përqëndruar në veprimtarinë institucionale të çdo strukture administrative apo gjyqësore ,duke bërë një analizë konceptuale të parashikimeve ligjore si dhe të aplikimit të ligjit në praktikë duke evidentuar nevojshmërinë urgjente të zbatimit të ligjit në çdo situatë pa neglizhuar asnjë element të çështjes i cili rezulton në cënim të të drejtave të konsumatorit në kontratat konsumatore



E drejta konsumatore në sistemin ekonomik të inicjativës së lirë mbart një rëndësi thelbësore ,kjo për shkak të faktit se në themel të këtij sistemi qëndron sjellja e çdo subjekti në treg për maksimizimin e fitimit,kjo sjellje orjenton në shkeljen e të drejtave të konsumatorëve të cilët nëse nuk do ti garantohen të drejtat e tij me ligj, ekziston risku potencial dhe real i cënimit shumë planësh të tij kjo si në pikëpamjen shëndetësore ashtu edhe atë ekonomike ,nga ana tjetër sipërmarrësit në treg do të realizonin përfitime në shkelje dhe në abuzim me statusin e tyre në treg,duke aplikuar kushte të padrejta në cënim të interesave të konsumatorit

Ky punim synon :

- ✚ Të prezantoi kuadrin ligjor të nevojshëm për mbrojtje dhe garantimin e të drejtave të konsumatorëve kundrejt kushteve të padrejta;
- ✚ Të trajtoi në këndvështrimin analitik jurisprudencën e GJED-së për ti dhënë një dimension praktik çdo kushti ligjor të domosdoshmë për praninë e kushti të padrejtë ;
- ✚ Të identifikohen mangësitë ligjore të brendëshme në raport me Direktivën 93/13/KEE;
- ✚ Të përcaktoi se për cilat arsye në Shqipëri konsumatori është më i ekspozuar kundërt dëmeve që passjell prania e kushtit të padrejtë në kontratën konsumatore
- ✚ Të përcaktohet se në cilat element të ligjit është i nevojshëm amendimi për të garantuar mbrojtje e të drejtave të konsumatorëve;
- ✚ Të përcaktoi nëse strukturat administrative ,dhe ato gjyqësore garantojnë *de facto* mbrojtjen e konsumatorit kundrejt kushteve të padrejta;
- ✚ Si dhe cilat janë aspektet juridike dhe praktike të cilat do të duhet të përmirësohen për të shmangur aplikimin e kushteve të padrejta ose në rast të kundërt sanksionimin e aplikimit të këtyre kushteve në dëm të konsumatorit;

Për realizimin e këtyre objektivave është e domosdoshme analiza e detajuar e literaturës vendase dhe të huaj kjo për të evidentuar mënyrën më efikente për mbrojtjen e konsumatorit si dhe garantimin e një fitimi të drejt të tregtarit.

Gjithashtu ky punim analizon efektshmërinë e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve në këtë fushë,pra efektiviteti i zbatimit të ligjit,është për tu nënvizuar që informacioni i publikuar nga

institucionet përkatëse<sup>1</sup> nuk pasqyronte problemet reale në zbatimin e ligjit, por vetëm publikimet mjaftoheshin me një analizë doktrinale të këtyre kushteve ,pa publikuar një monitorim të Ministrisë së zhvillimit Ekonomik,Turizmit,Tregtisë dhe Sipërmarrjes në varësi të së cilës është edhe Komisioni për Mbrojtjen Konsumatore<sup>2</sup> i cili duhet të evidentonte zbatimin e plotë të ligjit nga ky institucion.

Në realizimin e këtij punimi me qëllim përcaktimin e të drejtave të konsumatorit në Shqipëri ,si dhe parimet ku mbështetet kjo e drejtë,gjithashtu në mënyrë të përmbledhur garancitë që ofrojnë institucionet publike për mbrojtjen e të drejtës së konsumatorit në Shqipëri,është dashur hulumtimi në tërësinë e akteve kombëtare dhe ndërkombëtare kjo për të arritur në një konkluzion të qartë rreth garantimit real të kësaj të drejte në Shqipëri,për këtë qëllim:

**Metoda e analizës doktrinale:**E cila konsiston në evidentimin e literaturës përkatëse për këtë punim ,analizën e materialit dhe përcaktimin e konkluzioneve për çështjet e shtruara për diskutim.

**Metoda e analizës së legjislacionit:**E cila konsiston në evidentimin dhe analizën e legjislacionit që rregullon të drejtën e konsumatorit në Shqipëri ,analizën krahasuese të tij me *acquis communautaire* dhe praktikën gjyqësore kombëtare dhe komunitare,e cila ka shërbyer në përcaktimin e problematikave ligjore ,zbatimi i tij në praktikë dhe nevoja për ndërhyrje në mirëzbatimin e legjislacionit në tërësi për shmangien e aplikimit të kushteve në dëm të konsumatorin.

**Metoda e analizës historike:**E cila i referohet shkaqeve të cilat çuan në lindjen e të drejtës së konsumatorit ku shkakun predominues ishte pikërisht mbrojtja e konsumatorit nga abuzime të tregtarëve të cilët qëllim kryesorë kanë përfitimin nga aktiviteti tregtarë ,si dhe analizën e zhvillimit historik të kësaj të drejte si në planin kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar,kjo pasi nuk duhet të harrojmë se e drejta e konsumatorit ishte produkt i zhvillimit të vullshëm të tregtisë në shekullin e XX-të,çka krijonte domosdoshmërin për institucionet komunitare të mund të garantonin të drejtat e konsumatorëve në një treg gjithmon edhe më të madh dhe në zhvillim.

Kjo metodologji ka ndihmuar në evidentimin e efekteve të parashikimit ligjorë të kushteve të padrejta në kontratat konsumatore ,si dhe në evidentimin e nevojës për rishikim ligjor të ligjit për

---

<sup>1</sup> Ministria e zhvillimit ekonomik, turizmit, tregtisë dhe sipërmarrjes.

<sup>2</sup> Neni 49 pika 1,2/f ,52/8,56/1/1.1 I ligjit nr:9902 dt:17.04.2008”Për mbrojtjen e komsumatorëve” i ndryshuar.

mbrojtjen konsumatore sidomos në pjesën që trajtohen sanksionet(gjobat)<sup>3</sup>kundrejt aplikuesve të kushteve të padrejta në këto kontrata .

**Metoda hulumtuese:**Është përdorur në tërësinë e studimit. Kjo metod përmban procesin e mbledhjes së materialeve në format e shkruara dhe elektronike; të përzgjedjes së vendimeve gjyqësore në funksion të shkrimit dhe strukturës së temës. Kjo metodë ka qenë thelbësore në fazën e sistemimit të zërave bibliografik në funksion të finalizimit të këtij punimi.

Çështjet që shtrohen për diskutim janë:

- ✚ A shmang sanksionimi dhe ndalimi i aplikimit të kushti të padrejt në kontratën konsumatore ,vullnetin e tregtarit për përfshirje të këtyre kushteve në këto kontrata nëse konsumatori  nuk është aktiv në kërkimin e së drejtës dhe vënien në lëvizje të strukturave të posaçme administrative dhe gjyqësore për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga prania e këtyre kushteve?
- ✚ Sa janë efiçente garancitë ligjore në mbrojtjen e konsumatorit nga kushtet e padrejta në kontratat konsumatore?
- ✚ A respektohet në praktikë nga ana e institucionit të Komisionit për Mbrojtjen Konsumatore në mënyrë rigoroze ligji për mbrojtjen konsumatore kundrejt kushteve të padrejta në kontratat konsumatore si dhe cili është impakti i jurisprudencës së Gjykatës Europiane të Drejtësisë në respektimin e të drejtave të konsumatorit kjo për të garantuar mbrojtjen nga kushtet e padrejta në kontratat konsumatore?
- ✚ Dhe cilat janë pasojat juridike të shkeljes së ligjit për kushtet e padrejta në kontratat konsumatore ,a janë të ndjeshme sanksionet ligjore në rast shkelje të këtyre kushteve?

Tërësia e këtyre çështjeve është trajtuar në këtë punim duke mbajtur në fokus në çdo rast mbrojtjen e interesave të konsumatorit si palë më e dobët në kontratat konsumatore,si cila janë veprimet proceduriale të cilat duhet që konsumatori të mund ti ndjek në mbrojtjen e të drejtave të cënuara,gjithashtu në bazë të këtyre çështjeve ,dhe duke respektuar metodologjinë është arritur në konkluzione dhe rekomandime të përshtatshme për çështjen në fjalë.

---

<sup>3</sup> Neni 57 i ligjit nr:9902 dt:17.04.2008 “Për mbrojtje e konsumatorëve”I ndryshuar



## KREU I

### LINDJA DHE ZHVILLIMI I TË DREJTËS KONSUMATORE

#### *1.1.Lindja dhe zhvillimi i të drejtës konsumatore.*

Sikurse u përcaktua edhe më sipër kjo e drejtë lindi si një nevojshëri për mbrojtjen nga zhvillimi i menjëhershëm i ekonomisë dhe prodhimit si dhe nga varjacioni si në prodhim edhe në llojshmërinë e produktit, konsumatori ishte subjekti që mbarte riskun e dëmtimit në rast se nuk do të mbrohej me akte ligjore kombëtare dhe komunitare .

Në të drejtën komunitare fillimisht mbrojtja e të drejtave të konsumatorit u sanksionua në Traktatin e Romës, në vitin 1957 dhe si pasojë vitit 1973, miratohet Karta Evropiane për Informimin dhe Mbrojtjen e Konsumatorëve, akti i parë i cili përcaktoi shprehimisht të drejtat e konsumatorit si

- mbrojtjen nga rreziqet e jetës;
- mbrojtjen e shëndetit dhe pronës gjatë pranimin të produkteve/shërbimeve në treg;
- mbrojtje juridike dhe mbështetje shtetërore;
- informimi dhe arsimim;
- bashkimin në shoqata me qëllim të mbrojtjes së interesave të tyre;
- përfaqësimi në trupat vendim-marrëse mbi të drejtat dhe interesat e konsumatorëve.

Sikurse vihet re këto të drejta garantojnë efektivisht mundësinë e konsumatorit për të mbrojtur interesat e tij kundrejt abuzimit të ushtruar nga çdo tregtar në treg i cili kërkon maksimizimin e fitimit duke dëmtuar interesat e konsumatorit.

Mbështetur në këto parime Komuniteti Evropian ka hartuar strategji komunitare për mbrojtjen e konsumatorit, kjo gjithmonë në përputhje të plotë të zhvillimeve historike, kërkesave dhe interesave të konsumatorëve, gjithashtu edhe në respektim të zhvillimit të çdo shteti anëtar të BE-së.

Ndërkohë që Traktati i Maastrichtit ishte akti i cili vendosi detyrimin komunitar për të garantuar një mbrojtje minimale të të drejtave të konsumatorit përfshi këtu edhe planin social duke qartësuar

edhe detyrimin e shteteve anëtare për mbrojtjen me anë të sanksionimit të të drejtave të konsumatorit në kontratat konsumatore, Komisioni Evropian deklaroi nën titullin “Parimi i subsidiaritetit” se: *“Politikat në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit duhet të menaxhohen në mënyrë efektive nga Shtetet Anëtare mbi bazën e vazhdueshmërisë së menaxhimit dhe kontrollit të sigurisë, informimit dhe dëmshtëpërblimit, në përputhje me nevojat lokale të çdo instance. Marrja e të tilla masave në nivel komunitar në mënyrë të vazhdueshme nuk është reale”*<sup>4</sup> sikurse vihet re garantimi i të drejtave të konsumatorit do të realizohesh edhe me anë të dëmshtëpërblimit i cili do të aplikohet në rast shkelje dhe cënimi të këtyre të drejtave, por domosdoshmërisht niveli i dëmshtëpërblimit u la në tagër të shteteve anëtare

Më pas do të jetë Traktati i Amsterdimit (1997), i cili do të përcaktojë në mënyrë më të detajuar të drejtat që gëzojnë konsumatorët në treg, gjithashtu garantimin e instrumentave komunitarë të domosdoshëm për garantimin e të drejtave të konsumatorit si dhe mbrojtjes së interesave të tij, madje përcaktimin si detyrim të çdo shteti anëtarë për implementimin e politikave të brendshme garantuese të mbrojtjes konsumatore.

Kontretisht Neni 129/a u ndryshua, në nenin 153/2 dhe ai parashikoi se *“me qëllim promovimin e interesave të konsumatorëve dhe sigurimin e një niveli më të lartë të mbrojtjes së konsumatorëve, Komuniteti duhet të kontribuojë në mbrojtjen e shëndetit, sigurisë dhe interesave ekonomike të konsumatorëve, gjithashtu duhet të promovojë të drejtën e tyre për informim, edukim dhe të drejtën për t’u organizuar me qëllim mbrojtjen e interesave të tyre”*<sup>5</sup>

Edhe në këtë Traktat garantim i mbrojtjes dhe të drejtave ishte në nivel minimal, çka do të thotë se komuniteti vetëm përcaktonte në minimum të drejtat dhe mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit ,më pas do të duhet të ishin shtete anëtare të cilat duhe të zhvillonin dhe krijonin mekanizmat

---

<sup>4</sup> SELMANI.B-“ ROLI DHE POZITA E JURIDIKE E KONTRATAVE KONSENSUALENË SISTEMET E SË DREJTËS BASHKËKOHORE NDËRKOMBËTARE DHE KONSUMATORIT” Profesor Universitar, i lëndës “E drejta Romake –Ius Romanus” në Fakultetin Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës –Tetovë, 2015

<sup>5</sup> SELMANI.B-“ ROLI DHE POZITA E JURIDIKE E KONTRATAVE KONSENSUALENË SISTEMET E SË DREJTËS BASHKËKOHORE NDËRKOMBËTARE DHE KONSUMATORIT” Profesor Universitar, i lëndës “E drejta Romake –Ius Romanus” në Fakultetin Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës –Tetovë, 2015

shtetërorë të domosdoshmë për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit në çdo shtet antar.<sup>6</sup>

Momentalisht veprimtaria e BE-së është e mbështetur në Programin European për mbrojtjen e Konsumatorit ,e cila është një strategji e re në sinkron me politikat konsumatore të BE-së.Ky program ka si qëllim të tij garantimin e mbrojtjes së konsumatorit nga kushtet e padrejta ,informimin e konsumatorit,implementimin dhe zbatimin e politikave për mbrojtjen e konsumatorit.Gjithashtu këtu luan një rol shumë të rëndësishëm politikat e shteteve anëtare të cilat kanë për detyrë implementimin e politikave konsumatore të përcaktuara nga BE-së.

Me rëndësi shfaqet mbrojtja e të drejtave të konsumatorit në rastin e nënshkrimit të Prtneriteti Transatlantik në Investime dhe Tregti me SH.B.A çka edhe u shoqërua edhe me protesta në disa shete të BE-së kjo si një formë reagimi kundrejt kësaj marrëveshje e cila perceptohej si cënuse e të drejtave të konsumatorit,kjo për shkak të natyrës dhe llojit të produkteve të cilat do të importoheshin nga Shtetet e Bashkuara ,e cila riste koston e produkteve për konsumatorët e BE-së ,si dhe shtonte pasiguritë në lidhje me cilësinë e këtyre produkteve<sup>7</sup>,gjithashtu problematike nga shtetasit e BE-së shikohej edhe aplikim i kontratatve konsumatore të cilat mund të përfshinin kushte të cilat ishin të padrejta në këndvështrimin e legjislacionit komunitarë.

Gjithashtu një sër aktesh të tjera të cilat kanë në fokus të drejtat e konsumatorit janë të përcaktuara në diraktivat përkatëse ndër të cilat është edhe diraktiva për kushtet e padrejta në kontratat konsumatore Direktiva 93/13/EEC ,gjithashtu në këtë kontekst miratohet edhe Rezoluta nr. 39/248, më datën 09.04.1985,nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, derivat i së cilës ishte edhe Udhëzimi mbi mbrojtjen e konsumatorëve, i cili u jep qeverive mundësi për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacioneve për mbrojtjen e konsumatorëve,kjo duke përcaktuar minimumin e mbrojtjes së të drejtave të konsumatorit përfshirë këtu edhe trajtimin e kushteve të padrejta në kontratat konsumatore.

Duhet theksuar se Direktiva 93/13/EEC përbën një burim të rëndësishëm të garantimit të të drejtave të konsumatorit në rastin e kushteve të padrejta të aplikuara në këto kontrata ,kjo pasi kjo direktivë përcakton në nivel minimal se cilat do të konsiderohen kushte të padrejta në nivel

---

<sup>6</sup>G.HOWELLS- The Rise of European Consumer Law— Whither National Consumer Law?-Lancaster Law School, United Kingdom.-2013

<sup>7</sup> Office of Fair Trading press notice,"Fair terms in consumer contract - new powers come into effect",

European si dhe cili do të jetë efekti i këtyre kushteve të padrejta në këto kontrata konsumatore, gjithashtu përcaktohet detyrimi ligjor i çdo shteti anëtarë për garantimin e këtyre të drejtave duke krijuar kështu një udhërrëfyes të përshtatshëm për shtetet anëtare si dhe ato të cilat aspirojnë të jenë anëtare ,të BE-së duke përcaktuar disa kushte të cilat do të konsiderohen të padrejta dhe në dëm të konsumatorit. gjithashtu i është kushtuar rëndësi edhe procedurës se si këto kushte të padrejta janë përfshirë në kontratat konsumatore duke përcaktuar mirëbesimin e konsumatorit apo mungesën e përfshirjes së tij në negocimin e këtyre kushteve si një element thelbësorë në përcaktimin e një kushti si të padrejtë dhe për rrjedhojë evidentimin e pasojave përkatëse në aplikimin e këtyre kushteve.

Ndërkohë krahas Europës ku edhe e drejta konsumatore u zhvillua natyrshëm kjo fal zhgjerimit të tregut dhe nënshkrimit të një sërë traktatesh të cilat synonin përmirësimin e vazhdueshëm, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vitin 1872 miratohet ligji i parë në fushën konsumatore ku u synua për herë të parë mbrojtja e konsumatorit nga mashtrimet kundrejt produkteve gjithashtu edhe akti Sherman i vitit 1890<sup>8</sup> i cili edhe pse në thelb mbronte konkurrencën në treg indirekt kishte si synim mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet e ndërmarrjeve të mëdha të cilat kishin praktika monopolistike çmim-përcaktuese çka dëmtonte në thelb konsumatorin<sup>9</sup>

Ndërkohë i njihet një kontribut i jashtëzakonshëm Presidentit të SH.B.A-ve John F. Kennedy i cili sanksionoi për herë të parë rëndësinë e mbrojtjen e të drejtës së konsumatorit i cili përcaktoi katër të drejta themelore të të drejtës së konsumatorit siç është e drejta për t'u informuar, e drejta për të zgjedhur lirisht, e drejta për siguri, e drejta për t'u dëgjuar, të drejta këto që përbëjnë bazën e çdo legjislacioni për mbrojtjen e konsumatorit<sup>10</sup>

Në Shqipëri e drejta e konsumatorit vetëm pas ndryshimit të sistemit politik u arrit që të njihet si e drejtë dhe të mund të sanksionohet me ligj "Për mbrojtjen e konsumatorëve"<sup>11</sup> i cili garanton institucionalisht mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve në treg ,edhe ligji i vitit 2003 i cili garantonte të drejtat e konsumatorëve (ligji që shfuqizoi ligjin nr. 8192, date 06.02.1997 "Për mbrojtjen e konsumatorëve"), veçanërisht e drejta për tu mbrojtur nga kushtet e padrejta në

---

<sup>8</sup> "When the state harms competition-the role for competition law" -Eleonor M. FOX, Deborah HEALEY(2011)

<sup>9</sup> Akti i parë antitrust në mbrojtjen e konkurrencës ishte miratuar në Kanada in 1889, një vit më përpara se Kongresi I SH.B.A të miratonte Aktin Sherman Antitrust (1890). "Ehen the stata harms competition-the role for competition law" -Eleonor M. FOX, Deborah HEALEY(2011)

<sup>10</sup> <https://www.jfklibrary.org/JFK/Historic-Speeches.aspx>

<sup>11</sup> Ligji nr:9902/2008"Për mbrojtjen e konsumatorëve" i ndryshuar



kontratat konsumatore gjenin trajtim në këtë ligj<sup>12</sup> por shumë çështje si institucionet garant për zbatimin e ligjit si dhe natyra e sanksioneve e cila do të duhej të aplikohet gjithashtu firmosja e marrëveshjes së stabilizim asociimi me BE-në<sup>13</sup>, krijuan kushtet për të cilat u pa e domosdoshme hartimi i një ligji të ri si dhe amendimi i ligjit tashmë të hyrë në fuqi ligji i 2008 i cili do të pasqyronte edhe praktikën ndërkombëtare bazë edhe për ligjin aktuale, si dhe amendimet e tij të cilat pasqyrojnë situata të reja juridike në mbrojtjen e konsumatorit kundrejt kushteve të padrejta në kontratat konsumatore

### *1.2. Kushtet e padrejta në kontratat konsumatore në legjislacionin shqiptarë.*

Duhet theksuar se legjisalcioni shqiptarë përpara vitit 1990 nuk ofronte një mbrojtje eficiente të drejtave të konsumatorit kjo edhe për shkak të zhvillimeve ekonomiko-sociale të cilat nuk shfaqnin nevojshmërinë për mbrojtjen kundrejt këtyre kushteve ,duhet theksuar edhe se tërësia e marrdhënieve juridike në fushën konsumatore gjente mbrojtje nga e drejta zakonore dhe pjesërisht ajo fetare ,gjithashtu ekzistenca e formave të kontratave tipike në të drejtën civile nuk shfaqte nevojën për krijimi e kontratave edhe për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit ,kjo pasi edhe krijimi i këtij koncepti juridik dhe më pas mbrojtja e tij, fillesat i ka efektivisht në shekullin e njëzetë ,arsye pë të cilën edhe mbrojtja e këtyrë të drejtave si dhe shmangia e aplikimit të kushteve të padrejta gjithmon gjente mbrojtje në të drejtën zakonore<sup>14</sup>,arsye për të cilën deri në vitin 1990 këto kushte të padrejta nuk gjejnë sanksionim normative.

Në vitin 1990 me ndryshimet e sistemit ekonomik dhe atë politik si dhe me hapjn e tregut kundrejt produkteve të huaja lindi nevojshmëria për mbrojtjen ligjore të këtyre të drejtave,por duhet theksuar se fillimet e këtyre akteve të para garantojnë një mbrojtje më tepër në nivelin parimor se sa duke krijuar struktura efçente dhe reale të cilat mund të mbronin konsumatorin nga aplikimi i kushteve të padrejta në kontratat konsumatore.

<sup>12</sup> Pjesa IV neni 24 i ligjit nr:9135 dt:11.09.2003”Për mbrojtjen e konsumatorëve”I shfuqizuar nga ligji nr:9902 dt:17.04.2008.

<sup>13</sup> Marrëveshja e stabilizim asociimit midis Bashkimit Euroipa dhe Republikës së Shqipërisë ka hyrë në fuqi me 01.04.2009.

<sup>14</sup> SELMANI.B-“ ROLI DHE POZITA E JURIDIKE E KONTRATAVE KONSENSUALENË SISTEMET E SË DREJTËS BASHKËKOHORE NDËRKOMBËTARE DHE KONSUMATORIT” Profesor Universitar, i lëndës “E drejta Romake –Ius Romanus” në Fakultetin Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës –Tetovë, 2015

Konkretisht ligji nr:7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” ishte akti i parë i cili sanksionoi parimet e funksionimit të sitemit të ri pluralist si nga pikpamja ekonomike gjithashtu edhe nga ajo politike duke garantuar mbrojtjen parimore në rast të shkeljes së të drejtave të përcaktuara në këtë akt ,por për të drejtat konsumatore dhe për më tepër për mbrojtjen kundrejt kushteve të padrejta në kontratat konsumatore ishte “herët” që të mund të kishim një mbrojtje efiçente dhe të garantuar me institucione administrative të cilat do të mbronin konsumatorin kundrejt këtyre kushteve.

Në fakt akti i parë në mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve sanksionohet me ligjin e vitit 1997<sup>15</sup> ligj i cili garantonte në vija të përgjithshme mbrojtjen e të drejtave kryesore të konsumatorit por nuk përcaktonte një mbrojtje efiçente në rast të mbrojtjes kundrejt kushteve të padrejta arsye për të cilën edhe u shfuqizua nga ligji nr. 9135, datë 11.09.2003 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”,ky ligj përbën aktin i cili për të parën herë garanton mbrojtjen kundrejt kushteve të padrejta në kontratat konsumatore,ç’ka edhe përbën risinë e këtij ligji ,duhet theksuar se ndikimi ndërkombëtarë kjo me anë të raporteve të vazhdueshme<sup>16</sup> si dhe vëzhgimeve të strukturave europiane krjoi kushtet për mbrojtje kundrejt kushteve të padrejta nga pikpamja institucionale.

Gjithashtu një tjetër risi e rëndësishme nga pikpamja proceduriale ishte garantimimi i të drejtës së ankimit në strukturat administrative dhe më pas ato gjyqësore ,ç’ka shkoi paralel edhe me krijimin e këtyre stukturave administrative të cilia krahas garantimit të zbatimit të ligjit ,kishin një sër detyrash me natyrë informuse dhe raportuse në strukturat më të larta administrative.<sup>17</sup>

Duhet theksuar se sipas nenit 2 të këtij ligji(i cili përcakton objektin)“Ky ligj rregullon marrëdhëniet ndërmjet konsumatorëve, nga njëra anë dhe prodhuesve, shitësve, furnizuesve e ofruesve të shërbimeve, nga ana tjetër, si dhe përcakton të gjitha detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare, që kane lidhje me interesat e konsumatorit”,nga përcaktimi rezulton se objekti është më i gjerë në krahasim me ligjin e mëparshëm.

---

<sup>15</sup> Ligji nr. 8192, datë 06.02.1997 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”

<sup>16</sup> Raporti i BE-së për zhvillim 2016

<sup>17</sup> Neni 49 i ligjit nr. 9902 dt: 17.04.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”

Gjithashtu hyrja në fuqi e këtij ligji erdhi edhe si rezultat i miratimit të Kushtetutës së vitit 1998<sup>18</sup> e cila në përmbajtje kërkon mbrojtjene të drejtave të konsumatorëve kjo në pjesën e të drejtave sociale të çdo shtetasi<sup>19</sup>,element ky që ndikoi në shfuqizimin e ligjit të mëparshëm si dhe miratimin e një ligji të ri,por që nuk do të ishte i mjaftushëm për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit arsye për të cilën në vitin 2008 miratohet ligji i ri<sup>20</sup> i cili garanton një mbrojtje më të plotë dhe të gjithanshme të të drejtave të konsumatorit ,gjithashtu afron një sër kushtet dhe elementësh të cilët përcaktohen si kushte të padrejta në kontratat konsumatore,njëkohësisht garanton një mbrojtje më efizente institucionale të konsumatorit në rast të shkeljes së këtyre kusheve ligjore,njëkohësisht vihet re koherenc mes aspektit proçedural të këtij ligji më Kodin e Proçedurave Administrative <sup>21</sup> si në pjesën proçeduriale ashtu edhe në të drejtën materjale të garantuar nga ky ligj.

### *1.3.Aktet ndërkombëtare në mbrojtjen e konsumatorit kundrejt kushteve të padrejta.*

Sikurse është përmendur edhe më sipër aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e konsumatorit kundrejt kushteve të padrejta krahas Traktatit të Lisbonës akt i cili garanton mbrojtje në nivel minimal<sup>22</sup>,Komuniteti European njëkohësisht ka garantuar saksionimin edhe në nivel aktesh si p.sh. Rregullorja 27/1995 /EEC akti i cili përcakton një mbrojtje minimale kundrejt kushteve të padrejta në kontratat konsumatore,akt të cilin edhe në ligjin aktual për mbrojtjen e konsumatorit e gjejmë të pasqyruar në një sër aspektesh ,të cilat garantojnë mbrojtjen e konsumatorit.

Kjo Rregullore ka të përcaktuar shprehimisht se në cilat raste kushtet do të konsiderohet të padrejta <sup>23</sup>si dhe cili duhet të jetë qëndrimi i shteteve kundrejt tyre ,gjithashtu nxiten shtetet që të mund të

---

<sup>18</sup> Kushtetuta në formulimin dhe në përmbajtjen e saj u ndikua më së shumti nga praktika dhe e drejta nsërkombëtare,për të përcaktuar parimet bazë në mbrojtjen e të drejtave të shtetasve në përgjithësi si dhe të konsumatorit në veçanti.

<sup>19</sup> Neni 59/c/d i Kushtetutës-1998

<sup>20</sup>Ligjin nr. 9902 dt: 17.04.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”

<sup>21</sup> Me hyrjen në fuqi të K.PrA-ve (i ri) i cili specifikon parimin e ankimimit administrative dhe më pas atë gjyqësore ,kjo në rast të mos parashikimit të posa i cili specifikon parimin e ankimimit administrative dhe më pas atë gjyqësore ,kjo në rast të mos parashikimit të posaçëm të ligjit i cili mund të vetpërcaktoi se cila do të jetë proçedura fillestare që do të duhet të ndiqet fillimisht ajo administrative ,apo ajo gjyqësore

<sup>22</sup>Në respektim të sovranitetit të shteteve anëtare të BE-së është vendosur se aktet ndërkombëtare Traktati i Lisbonës do të përcaktoi një nivel minimal të mbrojtjes të të drejtave të sanksionuara në këtë akt ,kjo duke i lënë hapsirë shteteve anëtare në thellimin dhe sanksionimin më të plotë të të drejtave dhe detyrave të shtetasve të BE-së,kjo detyrë është përcaktuar edhe në nenin 9 të Direktivës 93/13/KEE të BE-së

<sup>23</sup> Konkretisht në shtojcën 1,2,3 ku përcaktohet se cilat do të konsiderohen kushte të padrejta dhe cilat jo ,njëkohësisht përmenden edhe rastet përjshimore nga kushtet e padrejta ,rast në të cilin tregtari shkarkohet nga përgjegjësia.

bejnë një zbatim sa më të plotë dhe të sakt të kësaj rregullore si në rastet e kushteve ,ashtu edhe në rastet përjashtimore.

Gjithashtu një tjetër akt shumë i rëndësishëm juridik si dhe më tepër i detajuar për mbrojtjen e konsumatorëve kundrejt kushteve të padrejta është edhe Direktiva 93/13/KEE akti i cili ka si qëllim përafrimin e legjislacionit në shtetet anëtare për mbrojtjen e konsumatorit kundrejt kushteve të padrejta<sup>24</sup> gjithashtu ky akt përcakton edhe rastet në të cilat do të duhet që kjo direktivë të mos zbatohet kjo pasi për rastet për të cilat nuk do të zbatohet kjo direktivë janë parashikuar akte specifike komunitare të cilat rregullojnë çështje për të cilat kjo direktivë nuk gjen zbatim.

Element i rëndësishëm i këtij akti është fakti se kjo direktivë krijon detyrime për shtetet anëtare që të mund të garantojnë procedurialisht ,duke përcaktuar strukturat institucionale të nevojshme për mbrojtjen kundrejt shkeljeve të kësaj directive gjithashtu përcaktohen edhe kushtet për përcaktimin e kushteve të cilat do të quhen të padrejta<sup>25</sup> gjithashtu kjo Direktivë përcakton se kushtet e padrejta do të duhet të vlerësohen edhe në raport me natyrën e sendit<sup>26</sup>, gjithashtu edhe përdorimin e një gjuhe e cila është e thjeshtë dhe e kuptueshme për konsumatorët <sup>27</sup>elemente këto të cilat do të duhet të pasqyrohen në legjislacionin e brendshëm të shteteve anëtare,kjo për të garantuar mbrojtjen gjithpërfshirëse të konsumatorit në çdo shtet të BE-së,elementi i gjuhës paraqet rëndësi thelbësore edhe në praktikën e kontratave në Shqipëri kjo pasi nuk kanë qenë të pakta rastet në të cilën për shkak të përdorimit të një gjuhe teknike janë firmosur kontrata në përmbajtje të të cilave kushtet e padrejta ishin vendimtare në cënimin e të drejtave të konsumatorit<sup>28</sup>

Por duhet theksuar se në këtë punim analiza krahasuese e legjislacionit të brendshëm dhe atij Komunitar si dhe praktika institucionale e strukturave administrative do të përcaktojnë praninë si dhe reagimin e institucioneve kundrejt këtyre kushteve të padrejta në kontratat konsumatore,edhe pse duhet theksuar se ligji aktual ,përcaktimet e kësaj Direktive i ka bërë pjesë të tij arsye për të cilën edhe ligji në fuqi ka pësuar dy amendime të rëndësishme si në rastet të cilat do të konsiderohen kushte të padrejta edhe elementi sanksionues i cili mbart një rëndësi thelbësore

---

<sup>24</sup> Neni 1 i Direktivës 93/13/KEE

<sup>25</sup> Neni 3 i Direktivës 93/13/KEE

<sup>26</sup> Neni 4 i Direktivës 93/13/KEE

<sup>27</sup> Neni 5 i Direktivës 93/13/KEE

<sup>28</sup> Cënimi i të drejtave konsumatore realizohet edhe për shkak të natyrës juridike të kontratave konsumatore si dhe procedurës në të cilën këto kontrata firmosen kjo duke pasqyruar kontrata konsumatore me kushte të padrejta.

*condition sine qua non* për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e konsumatorit kundrejt kushteve të padrejta në kontratat konsumatore.

#### *1.4.Politikat e mbrojtjes konsumatore kundrejt kushteve të padrejta*

Nga përkufizimi ligjor<sup>29</sup>,rezulton se konsumatori do të jetë çdo person fizik, që blen dhe përdor mallra ose shërbime për plotësimin e nevojave të veta dhe jo për qëllime që janë të lidhura me veprimtari tregtare, apo rishitjen e atyre mallrave, nga ky përkufizim rezulton se konsumatori duhet të plotësoj nevojat individuale dhe nuk duhet të ketë qëllim përfitimin arsye për të cilën edhe shteti duhet të garantoj një sër politikash të cilat mbrojnë qëllimin e konsumatorit i cili është thellësisht individual dhe primar.

Mbrojtja e konsumatorëve, në thelb mbart nevojën për siguri,dhe garanci nevojë e cila vetëm me politikat shtetërore mund të garantohet dhe të mbrojë konsumatorin ,kundrejt abuzimeve nga ana e tregtarëve të cilët përkundrejt fitimit shpesh çënojnë të drejtat e konsumatorëve duke shkelur ligjin dhe dëmtuar konsumatorin.

Mbrojtja e konsumatorëve nënkupton edhe mbrojtjen e plotë, gjithpërfshirëse dhe të drejtë të të drejtave të konsumatorëve, si në sferën e arsimimit, edukimit, informimit, por edhe në sfera të tjera dhe nga shkaqe, ndikime, veprime mashtruese, të cilët në përditshmërinë e konsumatorit, kanë potencial të rrezikojnë dhe dëmtojnë jetën, shëndetin, ambientin dhe familjen e tij.<sup>30</sup>

Niveli i zhvillimit të të drejtave të konsumatorëve, është derivatë dhe rezultat i një zhvillimi të caktuar ekonomiko-social të një vendi, çka mbart edhe domosdoshmërinë e një niveli të kënaqshëm të demokracisë dhe kulturës së zbatimit të ligjit në një shtet,kjo pasi shtete si Shqipëria të cilat hartojnë dhe miratojnë ligje shumë efiçente por që mbartin një kulturë të moszbatimit të tij ,janë të prirura që të mos i kenë efektet e menjëhershme të mbrojtjes ligjore që i ofrohet konsumatorit.

Në thelb politikat shtetërore kanë për detyrë vendosjen e objektivave efiçente dhe produktive institucioneve të ngarkuaran me zbatimin e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës,kryerja e detyrave

---

<sup>29</sup> Neni 3 pika6 e ligjit nr:9902/2008”Për mbrojtjen e konsumatorëve”I ndryshuar.

<sup>30</sup> Programi për mbrojtjen e konsumatorit 2016 – 2020-Tiranë

ligjore *garanton* efikasitet në mbrojtjen e një interesi publik I cili mbart edhe nevojshmërinë për shmangien e efekteve negative të moszbatimit të ligjit dhe abuzimit të ndërrmarjeve në treg të cilat kanë vetëm objektiv të tyre maksimizimin e fitimit dhe kjo realizohet shume lehtë në një shtet ku institucionet janë shumë efiçente në hartimin e politikave për mbrojtjen e konsumatorit kundrejt kushteve të padrejta por shfaqin inkompetencë në zbatimin e ligjit në praktikë kjo me efekte të drejtëpërdrejta te konsumatori<sup>31</sup>.

#### *1.5.Nevojshmëria për mbrojtje konsuamtoare.*

Në sistemin e ndërtuar mbi bazën e konsumit e cila është produkt i zhvillimit ekonomik të gjithanshëm,por gjithashtu edhe garantimit të barazisë dhe lirisë të çdo shtetasi në zhvillimin e çdo ideje e cila garanton zhvillim dhe mirëqënie por në kushtet kur konsumatori ndodhet në mundësi zgjedhjesh të shumta ,dhe në sistemin e një konkurrence jo të plotë në treg domosdoshmërisht lind nevoja për mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimi me pushtetin që tregu i lirë i jep çdo tregtari kjo për të aplikuar kushte jo të drejta në kontratat konsumatore.

Por cili është përkufizimi i konsumatorit,kush do të quhet konsumatorë dhe për pasojë edhe do të gëzojë mbrojtje ligjore?Konkretisht ligji nr:9902/2008”Për mbrojtjen e konsumatorëve”I ndryshuar,përcakton se konsumator do të quhet *“çdo person i cili blen ose përdor mallra apo shërbime për plotësimin e nevojave vetjake, për qëllime që nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare ose ushtrimin e profesionit”*<sup>32</sup>,nga ky përcaktim rezulton se konsumator mund të jetë *çdo person* ,por pa përcaktuar çfarë natyre juridike ka ky person duke lënë evazive natyrën juridike të personit që është subjekt i ligjit për mbrojtjen e konsumatorit për pasojë në praktikë kjo krijon paqartësi pasi kërkohet që ligjet të mund të kenë sinkron dhe koherenc terminologjike kjo për të shmangur keqinterpretimet dhe keqzbatimet në praktikë.

Qartësimi i natyrës juridike të personit që quhet konsumator është i domosdoshëm juridikisht,kjo edhe pse nga përkufizimi *perceprohet* se trajtohet personi fizik , është detyrë e çdo ligj i cili rregullon një marrdhëne juridike të caktuar të jetë i qartë në përkufizimet që përcakton,ndërkohë

---

<sup>31</sup> Unfair Terms in Consumer Contracts, Standing Committee on Law and Justice, NSW-September 2010.

<sup>32</sup> Neni 3 pika6 e ligjit nr:9902/2008”Për mbrojtjen e konsumatorëve”I ndryshuar.

që Direktiva 93/13/KEE bën një përcaktim të qartë të këtij koncepti juridik duke mos lënë hapsirë për interpretime<sup>33</sup>

Në një sistem ekonomik ku kërkohet vullnet i fortë për të krijuar dhe zhvilluar një aktivitet privat, dhe madje në disa sisteme shtetërore ku vështirësia e krijimit dhe zhvillimit të një aktiviteti ekonomik pengohet edhe nga politikat shtetërore, krijohen premisat që subjektet operuese në treg të drejtohen vetëm nga nevoja për maksimizimin e fitimit duke shkelur të drejtat e çdo konsumatori dhe kjo me pasoja edhe në shëndet.

Por edhe pse shteti mund të hartojë ligje të cilat mbrojnë të drejtat e konsumatorit kundrejt kushteve të padrejta madje duke qënë edhe në koherencë me *acquis communitatis*, shtrohet pyetja se cili është roli i konsumatorit<sup>34</sup> në mbrojtjen e të drejtave të garantuara jo vetëm me ligj por në mënyrë indirekte edhe me Kushtetutë<sup>35</sup>, a është ai i vetëdijshëm për këto të drejta? A ka konsumatori rol aktiv në raport me praninë e kushtit të padrejtë në kontratën konsumatore? Dhe cili është qëndrimi i institucioneve publike në garantimin e këryre të drejtave kjo për të shmangur aplikimin e kushteve të padrejta në kontratat konsumatore?

Shpesh edhe për shkak të një kulture akoma jo të konsoliduar të qytetarit aktiv në mbrojtje dhe denoncim të shkeljeve të të drejtave të shkeluara si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik ndodh shpesh që shkeljet janë të pa deklaruara dhe të pa ndjekura nga institucionet publike, për pasojë edhe njohuria si dhe informacioni i konsumatorit ( edhe pse prezumohet se me hyrjen në fuqi të ligjit ekziston edhe detyrimi dhe përgjegjshmëria si për konsumatorin edhe për institucionet përkatëse për zbatimin edhe për raportimin e çdo shkelje kundrejt konstatuarit), përsëri shifrat dhe raportimet e shkeljes së të drejtave të konsumatorëve nga vetë konsumatorët janë shumë të pakëta kjo pasi akoma nuk konsiderohet si një e drejtë e fituar por si një “*favor*” që tregtari i bën konsumatorit në rast të respektimit të ligjit, ky perceptimi i gabuar krijon kushtet për abuzim dhe inefiçencë të ligjit për mbrojtjen e konsumatorit si dhe mungesë të aktivitetit të institucioneve të ngarkuara për zbatimin e ligjit.<sup>36</sup>

---

<sup>33</sup> Neni 2/a e Direktivës 93/13/KEE

<sup>34</sup> Consumer protection, Competition and markets authority-UK-2015.

<sup>35</sup> Neni 59/c i kushtetutës 1998

<sup>36</sup> Politikat e BE për konsumatorët.

Por pavarësisht këtij fakti e drejta e konsumatorit duhet të garantohet përkundrejt kushteve të padrejta për disa arsye:<sup>37</sup>

➤ *së pari : përgjegjshmëria sociale e subjekteve operuese në treg.*

Subjektet operuese në treg kanë detyrimin e imponuar nga ligj të udhëhiqen nga norma etike dhe morale jo në përfitim të padrejtë në dëm të konsumatorit, gjithashtu në shërbimin e interes të konsumatorit dhe jo duke abuzuar me lirinë që të ofton konkurrenca e lirë në treg.

➤ *së dyti: përgjegjshmëria e konsumatorëve*

Trajtimi i konsumatorëve në respektim të plotë të ligjit favorizon ndërgjegjësimin e tyre për kërkimin e këtyre të drejtave në rast shkelje nga tregtarët, kjo madje mund të favorizoj organizimin e konsumatorëve në organizata privatë të cilat operojnë madje edhe medjatikisht për deklarimin e çdo rasti të shkeljes së të drejtave të konsumatorëve të treg.

➤ *së treti: kënaqësia e konsumatorit*

Mahatma Gandhi në një nga deklaratimet në komunikimin me ndërrmarjet të treg u shpreh "trajtoni sa më mirë konsumatorët tuaj" kënaqja e konsumatorit është çelsi i suksesit edhe për subjektet operuese në treg kjo pasi kështu garantojnë edhe vazhdimësinë edhe jetëgjatësinë e veprimtarisë së tyre, por njëkohësisht edhe maksimizojnë fitimin e tyre, qëllim për të cilin edhe këto subjekte marrin riskun të konkurrojnë në treg.

➤ *Së katërti: drejtësia sociale*

Grantimi dhe zbatimi i ligjit për mbrojtjen e konsumatorit gjithashtu jep efektet e një drejtësie sociale kjo duke balancuar nevojën e konsumatorit për të mira dhe shërbime me ambicjen e tregtarit për të përfituar, duke shmangur abuzimin e dy kahshëm si të tregtarit ashtu edhe të konsumatorit

Nga tërësia e këtyre arsyetimeve rezulton se e mbrojtja nga kushtet e padrejta në kontratat konsumatore jo vetëm që garanton të drejtat e konsumatorit nga abuzimet e ushtruara nga tregtari

---

<sup>37</sup> Consumer protection, Competition and markets authority-UK-2015.



por gjithashtu edhe nxit përfitimin e drejtë të tregtarëve të cilët edhe operojnë në treg kjo për maksimizimin e fitimit.

Nga ana tjetër sa më shumë aktiv të jetë konsumatori në mbrojtjen e të drejtave ta njohura me ligj ,gjithashtu edhe sa më i informuar të jetë ai rreth të drejtave të tij aq më eficient do të jetë ligji dhe institucionet do të jenë edhe më të vetëdijshme për funksionin dhe më të gashme për zbatimin e ligjit dhe akteve ndërkombëtare,kjo pasi ndërgjegjshmëria konsumatore si dhe organizimi në struktura shoqërore për mbrojtjen e të drejtave ligjore garanton një zbatim sa më të plotë dhe të gjithanshmë të ligjit dhe aktev ndërkmbëtare.

#### *1.6.Përgjegjësia e konsumatorëve në mbrojtjen nga kushtet e padrejta*

Konsumatori në treg në bazë të ligjit ka edhe përgjegjësinë për të qënë aktiv në mbrojtjen e të drejtave të garantuara nga ligji kjo pasi është mënyra më efiçente për zbatimin e ligjit dhe ndëshkimin e praktikave të cilat janë në shkelje të të drejtave të konsumatorit konkretisht ndër mjetet ligjore për mbrojtjen kunderjt kushteve të padrejta,unë vëçoj dy të cilat mbartin rëndësinë thelbësore në shmangien e praktikave kontaktuale të cilat praktikojnë kushtet e padrejta konkretisht:

#### ➤ së pari:*e drejta e informimit*<sup>38</sup>

Konsumatori ka të drejtë të informohet rreth të drejtave kontraktuale si dhe kushteve pjesë përbërëse të kontratës konsumatore gjithashtu ka detyrimin ligjor në deklarin dhe vënien në lëvizje të institucioneve administrative si dhe gjyqësore për sanksionimin e të drejtës si dhe aplikimin e masave shtrënguse kundrejt subjekteve të cilat kanë aplikuar kushte të padrejta në kontratën konsumatore

---

<sup>38</sup> Neni 51/2 I ligjit nr:9902 dt:17.04.2008”Për mbrojtjen e konsumatorëve”I ndryshuar.

➤ së dyti: *e drejta e ankimit*<sup>39</sup>

Konsumatori ka të drejtën që në rast shkelje të ligjit dhe aplikim të kushteve të padrejta kontraktuale të mund të ankimoi praktikën kontraktuale të paligjshme në institucionin administrative kompetent Komisioni për mbrojtjen konsumatore.

Këto të drejta (të cilat nuk janë shteruese) luajnë rol të rëndësishëm në respektimin e ligjit në kushtet kontraktuale konsumatore, duke garantuar respektimin e të drejtave të konsumatorit ,si dhe duke vendosur tregtarët në kushte obliguse për respektimin e ligjit kjo duke pasur parasysh edhe masat shtrënguese të aplikura si nga organet administrative ashtu edhe nga ato gjyqësore kjo me qëllim garantimin e zbatimit të ligjit.

Një element shumë i rëndësishëm kontraktual është vullneti për të lidhur këtë kontratë ,element ky i cili në rast të kontratave konsumatore është i cunguar kjo pasi që vullneti të jetë i plotë dhe i qartë kërkon informacion të plotë për tu formuar dhe në kontratat konsumatore kjo për shkak të natyrës juridike të këtyre kontratave informacioni është jo i plotë dhe për pasojë edhe vullneti do të jetë i cunguar për shkak se njoja e plotë dhe informimi i plotë gjithmon realizohet në një moment juridik të më vonshme nga momenti i firmosjes së kontratës pra jemi në një situatë *post factum* ku vullneti i konsumatorit gjithmon konsolidohet pas firmosjes së kontratës ,arsye për të cilën edhe ligji por edhe aket ndërkombëtre kërkojnë garanci të mjaftueshme për *vendicimin* e të drejtës dhe të dëmit të shkaktuar kjo për shkak të mirëbesimit (element thelbësor i këtyre kontratave dhe faktorizues në firmosjen e këtyre kontratave)gjithashtu firmosjes së këtyre kontratave konsumatore në kushte jo të përshtatshme për formimin e vullnetit të brendeshëm kjo pasi edhe koha është e shkurtër për formimin e një vullneti të plotë për pranimin dhe firmosjen e kontratës.<sup>40</sup>

Për sa më sipër e drejta e informimit edhe ajo e ankimit përbëjnë thelbin dhe garancinë më të plotë për mbrojtjen e konsumatorit kundrejt kushtëvë të padrejta ,por që këto të drejtat të realizohen kerkohet ndërgjegjësimit i plotë i konsumatorit për të drejtat dhe për procedurën sa më

---

<sup>39</sup> Neni 56/1 I ligjit nr:9902 dt:17.04.2008”Për mbrojtjen e konsumatorëve”I ndryshuar

<sup>40</sup> AMARILLIDE GENOVESE-Contratti di massa e contratti del consumatore-“Il problema dell’adesione a contratti predisposti”.2013

të thjeshtëzuar që mund të garantoj ligj në mënyrë që e drejta të mos shkelet ose në të kundërt të shpërblehet dëmi.

## KREU II

### KUSHTET E PADREJTA NË KONTRATAT KONSUMATORE DHE VEPRIMTARIA INSTITUCIONALE

#### *2.1. Kuptimi i kontratave konsumatore ,dhe Direktiva 93/13/KEE.*

Nocioni i kontratës rrejdh nga përmbajtja e Kodit Civil i cili përcakton kontratën si një veprim juridiki i bazuar mbi vullnetin e lirë të subjekteve që janë palët në kontratë <sup>41</sup>,kjo pavarësisht objektit të kontratës,domosdoshmërisht në sistemin ligjor ku faktor vendimtar është *liria e vullnetit të palëve*,kontrata është veprimi juridik i cili organizon dhe formalizon çdo veprim juridiko-civil të çdo subjekti të së drejtës<sup>42</sup> ,(kjo nga pikpamja ligjore )me elementin formal të saj (por jo vetëm) prodhon efektet ligjore të dëshiruara ose të padëshiruara kjo në rastin kur janë kryer veprime juridike të cilat kanë për pasojë pavlefshmërinë absolute<sup>43</sup> apo atë relative<sup>44</sup> të veprimit juridik.

Kontrata si një forëm ligjore e organizimit të çdo veprimi juridik dypalësh ose shumë palësh mbart detyrime dhe të drejtat e palëve të cilët angazhohen dhe bien dakortë të respektojnë kushtet specifike të nënshkruara në kontratë ,duke nënvizuar njëkohësisht edhe sanksionet në rast mosrespektim të detyrimeve kontraktuale çka shoqërohet gjithmonë me shpërblimin e dëmit shkaktuar palëve për shkak të mos respektimit të kontratës.<sup>45</sup>

Zhvillimet e shekullit të XX-të kanë krijuar kushtet dhe premisat ku kontratat konsumatore të krijohen dhe zhvillohen ndryshe si në formë ashtu edhe në përmbajtje ,gjithashtu edhe procedura e njohjes dhe firmosjes së kësaj kontrate është e ndryshme nga ajo standartja e njohur dhe parashikuar nga Kodi Civil,domosdoshmërisht kontratat standarte ku të drejtat dhe detyrimet penalitetet,dhe përjashtimet janë parashikuar dhe hartuar në mënyrë unilaterale nga njëra palë ,gjithmonë e më tepër mer një rol të rëndësishëm forma e transaksionit ekonomik-financiar,kjo duke shkurtuar kohën për pranimin dhe firmosjen e kontratës ,duke krijuar kushte të favorshme

---

<sup>41</sup> Neni 660,663 I Kodit Civil

<sup>42</sup> C. CASTRONOVO, “Introduzione”, in “Principi di diritto europeo dei contratti”, Milano, 2001

<sup>43</sup> Neni 92 i Kodit Civil i R.SH.miratual me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994

<sup>44</sup> Neni 94 i Kodit Civil i R.SH.miratual me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994

<sup>45</sup> Shpërblim dëmi kontraktual neni 698 i Kodit Civil i R.SH.miratual me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994

për qarkullimin më të shpejt të produktit ,por nga ana tjetër duke krijuar një risk konstant për konsumatorin i cili është praktikisht i detyruar të pranoj formën dhe procedurën atipike të lidhjes së një marrdhënie juridike.<sup>46</sup>

E drejta konsumatore duke qenë se në themel ka vullnetin e lirë të palëve për të përfituar shërbime dhe të mira të dyanshme ,të ndërsjellta dhe të domosdoshme, *ratio juris* i ligjit ka rregulluar sjelljen e çdo subjekti si konsumatorit ashtu edhe tregtarit ,këtë marrdhënie juridike ja ka nënshtruar efekteve që sjell kontrata si akti i vetëm civil i cili rregullon marrdhëniet juridiko-civile,kjo duke respektuar si kushtet ashtu edhe efektet që sjell lidhja e kontratës .

Gjithashtu një tjetër qëllim se përse legjislatori ka vedosur të rregulloj sjelljen konsumatore me kontratë dhe jo me një tjetër akt juridiko-civil siç mund të jetë një deklaratë noterjale lidhet sidomos me pasojat juridike që sjell kontrata ,pasoja të cilat janë reale ,dhe të rregulluara në Kodin Civil <sup>47</sup>kjo pavarësisht faktit se nëse këto kontrata janë tipike apo atipike,pikërisht për të mbrojtur palët në kontratën konsumatore dhe për ta bërë të detyrueshëm vullnetin e palëve në mënyrë të ndërsjellt ligji për mbrojtjen konsumatore ka parashikuar rregullimin e kësaj marrdhënie juridiko-civile nën termin *kontratë konsumatore*,duke i dhënë të drejtën konsumatorit që të mund të mbroj të drejtën e tij nga pikpamja proceduriale me padi ,ç'ka kërkon investim të gjykatës në këtë çështje,duke njohur kështu të gjitha efektet që njeh padia.

Por gjithashtu edhe për të lehtësuar edhe qarkullimin juridiko-civil ku këto kontrata tashmë formohen në respektim të ligjt për mbrojtjen konsumatore dhe palët vetëm firmosin arritjen e marrëveshje mes tyre.

Njëkohësisht edhe Direktiva 93/13/KEE bën të njëjtin përcaktim dhe rregullim të kontratave konsumatore në rastin e kushteve të padrejta ,kjo duke konsideruar faktin se këto forma kontratash janë shumë të përhapura dhe përbëjnë praktikën në një sër mardhëniesh juridiko-civile arsye për të cilën edhe kjo Direktiv ka bërë një përcaktim të qartë të përcaktimit dhe evidentimit

---

<sup>46</sup> A mettere in rilievo la matrice economica del fenomeno giuridico della contrat-tazione di massa è F. GALGANO ,Diritto ed economia alle soglie del nuovo millennio in Contr. e impr 2000, 196.

<sup>47</sup> Neni 690-704 i Kodit Civil i R.SH.miratual me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994

shprehimisht të kushteve të cilat do të konsiderohen të padrejta ,gjithashtu rregulimi e kësaj marrdhënie juridike e ka përcaktuar nën termin kontrate dhe jo një tjetër akt komunitar.

Gjithashtu duhet theksuar se arsyet që ishin determinante për miratimin e kësaj Direktive nga Komuniteti European ishte nga njëra anë mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve por gjithashtu edhe nga ana tjetër mbrojtja e konkurrencës në treg pasi kujtomë se në vitin 1993 kur është miratur kjo Direktive përkon me nevojën për krijimin e një tregu të përbashkët si dhe me domosdoshmërinë për të shmangur abuzimet në raport me të drejtata e konsumtorit në BE,gjithashtu detyrën për garantimn dhe mbrojtjen e më tejshme të të drejtave të konsumatorit Direktiva përcakton se ja lë në dorë shteteve, duke vendosur kështu vetëm një nivel mbrojtje minimale të këtyre të drejtave në raport me kushtet e padrejta në kontratat konsumatore<sup>48</sup>

Gjithashtu Direktiva bën përjashtim kunderjt akteve si kontratat në lidhje me punësimin, kontratat që kanë të bëjnë me të drejtat e trashëgimisë, kontratat që lidhen me të drejtat sipas ligjit familjar dhe kontratat lidhur me themelimin dhe organizimin e shoqërive tregtare ose marrëveshjeve të partneritetit,kjo krahas faktit se këto janë marrëdhënie të cilat rregullohen me ligje të posaçme të shteteve anëtare,por edhe objekti i këtyre marrëdhënieve juridike paraqet *raio* të cilat nuk mund të rregullohen me kontrata të ngjashme me kontratat konsumatore.

Por cila është mënyra dhe kushtet e lidhjes së kësaj kontrate dhe në cilat raste ajo është e dëmshme për konsumatorin?Direktiva ka përcaktuar se cilat do të jenë palët në këtë kontrat konsumatore si dhe bën një përkufizim të plotë të nocionit tregtar dhe konsumatorë,dhe konkretisht përcakton se tregtarë do të quhet “*çdo person fizik ose juridik i cili, në kontratat e mbuluara nga kjo direktivë, po vepron për qëllime që lidhen me tregtinë e tij, biznesin ose profesionin, qoftë në pronësi publike ose në pronësi private*”<sup>49</sup>,gjithashtu edhe për nocionin e konsumatorit kjo direktivë bën një përcaktim të plotë dhe të qartë duke përcaktuar se konsumatorë do të quhet“*çdo person fizik i cili, në kontratat e mbuluara nga kjo direktivë, po vepron për qëllime që janë jashtë tregtisë së tij, të biznesit ose profesionit*”<sup>50</sup> përcaktim i cili është adoptuar jo plotësisht edhe nga ligji shqiptarë i cili ka përcaktuar se palët në ato që quajmë kontrata konsumatore kanë një status dhe përkufizim që përbën përjashtim nga rregulli i përgjithshëm arsye për të cilën edhe është rregulluar nga një

---

<sup>48</sup> Neni 9 i Direktivës 93/13/KEE

<sup>49</sup> Neni 2/a i Direktivës 93/13/KEE

<sup>50</sup> Neni 2/b i Direktivës 93/13/KEE

ligj i posaçëm ,në këto kontrata palët janë *tregtari* dhe *konsumatori* të cilët nëpërmjet vullnetit të tyre krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike në lidhje me mallra apo shërbime të ndryshme në treg.

Ndërsa termi konsumatorë e gjejmë të përcaktuar më sipër termi ‘tregtar’ përjufizohet “*si çdo person fizik ose juridik, i cili vepron për qëllime që lidhen me veprimtarinë e tij ekonomike, tregtinë, biznesin, zanatin ose profesionin, si dhe cilido, që vepron në emër ose në interes të tregtarit*“ kjo kontratë e lidhur në përputhje me ligji, ashtu si çdo kontratë tjetër, si rregull ka forcën e ligjit për palët,<sup>51</sup> pra nga sa vihet re edhe ligji ka bërë një përcaktim të ngjashëm të nocionit tregtar dhe konsumatorë.

Nga ana tjetër kontratat konsumatore janë rregulluar me një ligj të veçantë jo vetëm për shkak të rëndësisë që mbartin por edhe për shkak të efekteve juridike që ato sjellin ,këto kontrata kanë si qëllim mbrojtjen dypalëshe si të konsumatorit ashtu edhe të tregtarit por *ratio* se përse konsiderohen kontrata konsumatore qëndron në faktin se synojnë garantimin e të drejtave të konsumatorit përkundrejt abuzimeve të tregtarit,gjithashtu edhe për faktin se konsumatori e lidh këtë kontratë për shkak *nevoje* objektive vetjake,arsye për të cilën edhe Direktiva ka përkufizuar një mbrojtje më të plotë të të drejtave të konsumatorit duke përcaktuar shprehimisht rastet se kur një kusht kontraktual do të konsiderohet i padrejtë.

Duhet theksuar se këto kontrata janë tashmë nga praktika të standartizuara dhe të zbatueshme në çdo transaksion që ka për palë konsumatorin,si të tilla konsumatori vendoset përballë zgjedhjes së detyrueshme të përfitimit ose jo të shërbimit ose sendit,kjo duke *e përjashtuar* plotësisht nga procesi i përcaktimit të kushteve përbërëse të kontratës praktikë e cila krijon kushte favorizuese për përcaktimin e njëanshëm të kushteve të kontratës dhe për pasojë për abuzimin me këto kushte.<sup>52</sup>

Avantazhet e kushteve standarte në kontratat standarte qëndron në faktin se, subjektet në treg me anë të kësaj praktike kontraktuale arrijnë që të shmangin mosmarrëveshjet gjithashtu kanë

---

<sup>51</sup> Neni 690 i Kodit Civil i R.SH.miratual me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994

<sup>52</sup> Legjislacioni për mbrojtjen e konsumatorit- Shpjegues për praktikën e padrejta tregtare Shpjegues për kushtet e padrejta në kontrata-Tiranë 2015.

mundësi të parashikojnë rezultatin duke u përpjekur të shmangin dështimin ,por gjithashtu edhe duke kërkuar të maksimizojnë fitimin.<sup>53</sup>

Ndërkohë nuk mund të thuhet e njëjta gjë për konsumatorët të cilët edhe pse trajtohen në kushte barazie me tregtarët në treg,kjo një barazi formale kjo pasi janë palë në një kontratë ,ata nuk janë pjesë aktive e hartimit dhe përpilimit të kushteve të këtyre kontratave çka i vendos ata jo në kushtë të barabarta në lidhje me përcaktimin e kushteve kontratuale,ky pozicion praktikisht konsumatorët i vendos përball dy zgjedhesh ose pranimin ose mospranimin e kontratës ,por ata nuk kanë praktikisht mundësinë të negocjonë kushtet e kontratës ,çka do të thotë pozicion i pabarabartë me tregtarin në treg.

Gjithashtu Direktiva i ka dhënë përparësi edhe natyrës së mallit element ky i cili është vendimtarë në përcaktimin nëse kemi të bëjmë me kushte të padrejta ose jo ,kjo pasi natyra e malli përcakton edhe kushtet mbi të cilat do të ndërtohet kontrata gjithashtu edhe krijon kushtet për të bërë të mundur që konsumatori të mund të gëzojë mbrojtje ligjore në rast të cënimit të të drejtave të garantuara nga ligji dhe Direktiva<sup>54</sup>

## *2.2.Analiza e kushteve të padrejta në kontratat konsumatore dhe Direktiva 93/13/KEE*

Direktiva 93/13/KEE ka përcaktuar rregullat bazë për praninë e kushtit të padrejtë në kontratat konsumatore për përcaktimin dhe vlerësismin e një kushti të padrejtë përdor elementin kushtëzues *në qoftë se* ku evidentohen kriteret për praninë e një kushti të padrejtë në kontratat konsumatore ku sipas së cilës kushti do të konsiderohet i padrejtë nëse nuk është negociuar në baza individuale<sup>55</sup>dhe në kundërshtim me rregullat e mirëbesimit krijon një pabarazi domethënëse në të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontrata e palëve, dhe kjo pabarazi është në dëm të konsumatorit.

Domosdoshmërisht kjo Direktivë garanton mbrojtje të çdo konsumatori në rastin kur kemi praninë e këtyre elementëve në kontratat konsumatore kjo pasi një nga elementët thelbësorë të procesit për

---

<sup>53</sup> Unfair contract terms guidance Guidance for the Unfair Terms in Consumer Contracts .UK-September 2008

<sup>54</sup> V. ROPPO, Parte generale del contratto, contratti del consumatore e con tratti asimmetrici, cit., 683,2009.

<sup>55</sup> Neni 3 i Direktivës 93/13/KEE



lidhjen e kontratës është pikërisht faza parakontraktore ku palët kanë mundësinë që të mund të shqyrtojnë çdo aspekt të kontratës përfshirë këtu edhe kushtet por në rastin kur kjo fazë mungon konsumatori është thelbësisht i ekspozuar ndaj kusheve kontraktuale të cilat janë të pa negociuara më parë dhe për më tepër janë të njëanshme si dhe në dëm të konsumatorit, kjo pikërisht për shkak të faktit se në këto tip kontratash mungon faza parakontraktore e cila shërben për konsolidimin e vullnetit të palëve si dhe për marrjen e një vendimi në njohuri të plotë të kushteve, kjo krijon kushtet që tregtari të mund të “abuzoi”<sup>56</sup> me kushtet e përfshira në kontratë kjo duke shkaktuar dëm kundrejt konsumatorit, arsye për të cilën kjo Direktivë ka trajtuar tërësinë e elementeve të cilat duhet të jenë të pranishme për evidentimin e një kushti të padrejtë në kontratat konsumatore.

Duhet theksuar se edhe ligji për mbrojtjen e konsumatorëve i vitit 2003 kishte një sër mangësish në trajtimin dhe mbrojtjen e konsumatorit kundrejt kontratave të hartuara më parë dhe të cilat konsumatori është i detyruar për shkak të dinamikës të mund të firmos pa qënë në djeni të plotë rreth përmbajtjes së tyre si dhe pa pasur mundësinë e negociimit të tyre më pas sikurse vihet re këto janë kontrata të cilat janë atipike të cilat nuk pajtohen me një sër elementësh të domosdoshëm të parashikuar nga Kodi Civil<sup>57</sup> dhe nëse nuk do të ishte parashikuar në mënyrë specifike në ligj si dhe nëse nuk do të ishte rregulluar kjo praktikë e cila vjen si rezultat i dinamikës së vazhdueshme të ekonomisë dhe të tregut ,atëher do të mund të arrihej në konkluzionin ligjor se këto kontrata për aq kohë sa nuk respektojnë fazat kontraktuale si dhe formën e parashikuar në Kodi Civil do të kishin efekt juridik *nul*<sup>58</sup> për palët ,çka edhe do të përbënte një pengesë të vazhdueshme për dinamikën e të tregut dhe formave të tij të reja të shfaqjes së vullnetit ,ku në themel të së cilave qëndron parimi i liris së vullnetit dhe detyrimit ligjor që vetëm të përcaktoi se kur kjo shfaqje vullneti është e ligjshme dhe kur ajo është jo e ligjshme.

Ndërkohë në ato raste kur vullneti i shfaqur në formën e një veprimi juridik paraqet rëndësi për të tretët ligji gjithashtu duhet të rregulloi edhe formën si dhe procesin e njohjes së këtij vullneti të tretëve, kjo për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të tretëve, arsye për të cilën edhe u pa e domosdoshme hartimi i një ligji i cili do të duhej të ishte konform Direktivës 93/13/KEE, kjo për të rregulluar një marrëdhënie kontraktuale e cila për nga natyra dhe dinamika e saj është e “shpejt”

---

<sup>56</sup> P. PERLINGIERI, Nuovi profili del contratto,- 2001, fq.243.

<sup>57</sup> Neni 664-680 Kodi Civil miratuar me ligjin nr:7850 dt:29.07.1994 i ndryshuar.

<sup>58</sup> Neni 686 Kodi Civil miratuar me ligjin nr:7850 dt:29.07.1994 i ndryshuar.

dhe si e tillë kërkon një rregullim të shpej por të drejtë pa shkelur të drejtat e konsumatorit dhe duke shmangur çdo dëm që konsumatorit mund ti vij nga kjo kontratë konsumatore.

Arsye për të cilën kushtet e padrejta në kontratat konsumatore mund të kenë natyrë të ndryshme juridike kjo në saj të llojit të kontratës konsumatore si dhe në varësi të objektit të kontratës, ligji për mbrojtjen konsumatore ka përcaktuar parimet bazë mbi të cilat mund institucionet administrative ose ato gjyqësore të konkludojnë se jemi përpara një kushti të padrejtë kontraktual.

Konkretisht në bazë të Direktivës<sup>59</sup> dhe ligjit për mbrojtjen konsumatorëve do të jemi përpara një kushti të padrejtë kontraktual nëse:

- *Kushti i padrejt nuk ka qënë negociuar veçmas*
- *Kushti është i padrejt nëse shkaktojnë pabarazi në të drejta dhe detyrime mes palësh në në dëm të konsumatorëve.*
- *Nëse në nënshkrimin e kushtit të padrejtë është pranija e mirëbesimit*

### *2.2.1. Kushtet e padrejta nuk duhet të kenë qënë negociuar veçmas*

Kushti jo i negociuar veçmas pra mungesa e fazës parakontraktore përbën një nga kushtet në prezenc të së cilës një kusht do të konsiderohet i padrejtë, Direktiva e veçon mungesën e negociimit pikërisht për shkak të faktit se falë kësaj mungese kontratat do të konsiderohen konsumatore si dhe do të jenë objekt i Direktivës dhe i ligjit të brendëshëm, konkretisht Direktiva përcakton se një term gjithmonë do të konsiderohet si jo i negociuar individualisht, kur ai ka qënë hartuar më parë dhe konsumatori për këtë arsye nuk ka qënë në gjendje të ndikojë në përmbajtjen e kushtit, veçanërisht në kontekstin e një kontrate standard të para formuluar.<sup>60</sup>

Element ndikues në vlerësismin e një kushti të padrejtë është pikërisht mungesa e mundësisë së konsumatorit për të ndikuar në përmbajtjen e kushtit arsye për të cilën edhe efekti i saj është në

---

<sup>59</sup> Direktiva 93/13/KEE,

<sup>60</sup> Neni 3/2 e Direktivës 93/13/KEE.

shkelje të të drejtave të konsumatorit dhe me pasojë shkaktimin e një dëmi i cili duhet të shpërblehet nga tragtari

Në rastin kur tregtari pretendon se një kusht standard ka qenë i negociuar veçmas, barra e provës në këtë drejtim do të jetë detyrë e tij <sup>61</sup>, duke garantuar kështu mbrojtje për konsumatorin. Direktiva vendos detyrimin e provueshmërisë së faktit nëse kushti është negociuar veçmas këtë e vendos si detyrim të tregtarit duke shkarkuar nga përgjegjësia konsumatorin dhe duke lehtësuar procedurialisht pozitën e tij juridike.

Në kontratat konsumatore janë një sër kushtesh të cilat për shkak të objektivit të kontratës nuk janë negociuar veçmas, kjo pasi vetë natyra juridike e kontratës nuk e mundëson negociimin, domosdoshmërisht mungesa e negociimit mund të ketë lehtësuar nënshkrimin e kontratës, dhe më pas mund të rezultoi që kushtet e panegociuara mund të kenë dëmtuar rëndë konsumatorin.

Në këtë rast konsumatori mund të kundërshtojë *vetëm* për ato kushte të cilat nuk janë negociuar veçmas, ose ato kushte të cilat njihen si kushte standarde <sup>62</sup>, pra janë të njëjta në të gjitha kontratat që një tregtar lidh me konsumatorët, pasi synojnë të disiplinohen në mënyrë uniforme marrëdhënie kontraktore të caktuara, gjithashtu janë pikërisht këto kushte të cilat janë të hetueshme si nga institucionet administrative ashtu edhe nga ato gjyqësore, kjo pikërisht për shkak të faktit që konsumatori është *prezumuuar* se ka nënshkruar duke mos qënë pjesë aktive e negociimit dhe përpilimit të kushteve të kontratës, pasoj e së cilës është edhe trajtimi i kushteve të padrejta kontraktuale.

E kundërta e kësaj situatë (sipas ligjit) shkakton pamundësinë juridike të konsumatorit për ankim kjo në rastin ku konsumatori ka qënë pjesë aktive e negociimit dhe përpilimit të kushteve kontraktuale në këtë situatë në rast ankimi nga konsumatori për praninë e kushtit të padrejtë në kontratën konsumatore barra e provës i përketë tregtarit i cili duhet të provoj se kushti është negociuar veçmas.

Po në rastin kur mund të jetë negociuar një kusht i caktuar i kontratës por jo kontrata në tërësi a mund konsumatori të ankimohet cënimi i shkaktuar nga kushti i padrejtë në kontrata

---

<sup>61</sup> Neni 3/2 e Direktivës 93/13/KEE.

<sup>62</sup> Neni 28/2 i ligji nr:9902 dt:17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve" I dryshuar

konsumatore? Vetëm nga fakti që kontrata konsumatore është standarte përbën një shkak të mjaftueshmë për hetim administrativ apo gjyqësorë<sup>63</sup>, domosdoshmërisht ky kontroll do të ushtrohet mbi pjesën tjetër të kontratës e cila nuk i është nënshtruar negocimit dypalësh duke qenë se këto kushte kontraktuale janë produkt i vullnetit vetëm të një pale, atëherë ato do të jenë pjesë e shqyrtimit administrative ose gjyqësore.

Por a prezumohet në mirëbesim konsumatori edhe kundrejt dy elementeve thelbësorë të kontratës sikurse është çmimi dhe objekti i kontratës? Këto dy elemente janë kushte thelbësore të lidhjes së kontratës dhe si të tilla, ato ndikojnë në formimin e vullnetit të konsumatorit për të lidhur kontratën, arsye për të cilën edhe prezumohet se kushte të tilla janë pasojë e vullnetit të plotë dhe të lirë të palëve.

Të qënurit kusht thelbësor në lidhjen e kontratës mbart edhe efektin e përjashtimit nga vlerësimi i padrejtësisë së kushtit, por që të gëzojnë këtë efekt ligjorë kërkohet transparencë.<sup>64</sup> Çka do të thotë se konsumatori duhet të ketë të qartë efektet ekonomike të sendit ose shërbimit të përfutur gjithashtu konsumatori duhet të ketë mundësinë të parashikojë pasojat dhe pozitën ekonomike, në të cilën vendoset në një kohë afatgjatë pas lidhjes së kontratës.

Por në rastin kur këto kushte janë të paqarta dhe jo transparente a do të garantohet mbrojtje për konsumatorin? Domosdoshmërisht konsumatori në kushtet e mirëbesimit e ka të vështirë të mund të evidentoi shkeljen e të drejtave që sjell nënshkrimi i kontratës në të cilën kushtet thelbësore janë jo të qarta ose jotransparente, dhe në këtë rast dëmtimi i konsumatorit është i pashmangshëm, në këto kushte ligji nuk mund ta lërë pa mbrojtje konsumatorin por atij i jepet e drejta e ankimit në rast se këto kushte thelbësore të kontratës kanë qënë jo të qarta për konsumatorin dhe zgjidhja e tij është sugjestionuar nga sjellja e tregtarit e cila ka prirjen të mund të përfitoi qoftë edhe në shkelje të të drejtave të konsumatorit.

### *Jurisprudenca e GJED-së në analizën e kushtit të padrejt të panëgociuar*

Mungesa e negocimit të kushtit automatikisht bën të aplikueshme ligjin dhe Direktivën si një bazë e mjaftueshme ligjore për mbrojtjen e të drejtave të cënuara, por edhe për konsumatorin

---

<sup>63</sup> Neni 55 I ligjit nr"9902 dt"17.04.2008" "Për mbrojtjen e konsumatorëve" I ndryshuar.

<sup>64</sup> Unfair Terms in Consumer Contracts Regulations 1999, United Kingdom, and the Fair Trading Act 1999, Victoria

garantimi dhe mbrojtja e të drejtave nuk duhet të jetë e kushtushme dhe *quasi* e perealizueshme proceduralisht kjo në rastin kur praktikisht e drejta e ankimit bëhet e pamundur për shkak të koston dhe pamundësisë objektive kjo në rastin kur institucioni për zgjidhjen e konfliktit do të jetë Gjykata ku tregtari ka selinë ose qendrën e tij në fakt ky element u shqyrtua nga GJED-së në vitin 2000<sup>65</sup> ku gjykata në analizë të fundit të rastit në të cilin tregtari kishte vendosur si kusht kontraktual detyrimin për shqyrtim të çdo ankese nga Gjykata e Barcelonës vend ku tregtari kishte edhe selinë e tij.

Kjo u trajtua si kusht i padrejt ,pasi ishte detyrim i tregtarit njoftimi i mëparshëm i konsumatorit për përcaktimin se cila gjykatë do të kishte juridiksion në shqyrtimin e çdo ankese,si dhe mosrealizimi i këtij detyrim dhe përfshirja në kontratë si një kusht të panegociuar me parë,çënon të drejtën e ankimit të konsumatorit kjo pasi praktikisht bëhet e perealizueshme e drejta e ankimit si dhe nga ana tjetër ndjekja e seancave gjyqësore në qytetin e Barcelonës e shkakton një rritje të koston së konsumatori për të ndjekur në mënyrë të vazhdueshme seancat gjyqësore.

Gjithashtu gjykata përcakton se “*në rastin e mosmarrëveshjeve në lidhje me sasi të kufizuar të parave, shpenzimet që lidhen me e konsumatorin ,mund të jetë një pengesë dhe do të shkaktojë atë që të heq dorë nga ndonjë mjet juridik apo mbrojtjes, një kusht i tillë në këtë mënyrë bie në kategorinë e termave të cilat kanë objekt ose efektin e përjashtimit ose pengojnë të drejtën e konsumatorit të ndërmarrë veprime ligjore,*”<sup>66</sup> kategori të përmendura në nënparagrafin (q) të paragrafit 1 të Shtojcës së Direktivës”,gjithashtu gjykata përcakton se kur një klauzolë juridiksioni është përfshirë, pa u negociuar individualisht, në një kontratë ndërmjet një konsumatori dhe tregtarit brenda kuptimit të Direktivës dhe ku ajo i jep juridiksion ekskluziv mbi një gjykatë në juridiksionin territorial të cilit tregtari e ka vendin e tij kryesor të biznesit, ajo duhet të konsiderohet si e padrejtë brenda kuptimit të nenit 3 të Direktivës për aq sa ajo shkakton, në kundërshtim me kërkesat e *mirëbesimit*, një çekuilibër të rëndësishëm në të drejtat dhe detyrimet e palëve që rrjedhin sipas kontratës, në dëm të konsumatorit<sup>67</sup>.

---

<sup>65</sup> Océano Grupo Editorial SA v Rocio Murciano Quintero , Salvat EDITORES SA v José M. Sánchez Alcón Prades ,José Luis Copano Badillo , Mohamed Berroane , Emilio Viñas Féliu -2000

<sup>66</sup> Kategori të përmendura në nënparagrafin (q) të paragrafit 1 të Shtojcës së Direktivës 93/13/KEE

<sup>67</sup> Océano Grupo Editorial SA v Rocio Murciano Quintero , Salvat EDITORES SA v José M. Sánchez Alcón Prades ,José Luis Copano Badillo , Mohamed Berroane , Emilio Viñas Féliu -2000

Madje gjykata përcakton nevojshmërinë dhe gadishmërinë e shteteve anëtare që të mund të hartojnë akte ku kushtet të cilat do të konsiderohen të padrejta të mund të publikohen dhe të krijohen kushte që ky akti të mos jetë shterues por të jetë përcaktues dhe referues për çdo kontratë të ardhshme e cila duhet të hartohet në respektim të plotë të të drejtave të konsumatorëve kjo për të shmangur përsëritjen e rasteve të ngjashme të cilat duhet të shqyrtohen nga gjykata ,por njëkohësisht të mund të shmangen shpenzimet e tepërta nga konsumatorët dhe strukturat administrative të mund të vendosin për çështjet pa qenë nevoja për shqyrtim në Gjykatë ,kjo duke krijuar edhe një ekonomi gjyqësore të nevojshme për gjykatat e shteteve po edhe për GJED-së.<sup>68</sup>

### *2.2.2.Kushti është i padrejtë nëse shkakton pabarazi në të drejta dhe detyrime mes palësh në dëm të konsumatorëve*

Është i dukshëm fakti se pozita e pabarabartë mes tregtarit dhe konsumatori krijon kushte të favorshme që kjo pabarazi të reflektoj në përmbajtje të kontratës konsumatore ,gjithashtu duke pasur prezent edhe faktin e presionit të vazhdueshëm të tregut ,si dhe nevojën për maksimizimin e fitimit prania e kushteve të cilat krijojnë pabarazi në të drejta dhe detyrime mes palësh dhe në dëm të konsumatorit krijon detyrimin për mbrojtjen e këtyre të drejtave dhe shmangien e shkakimit të dëmit kundrejt konsumatorit si pala më e ekspozuar ndaj rrezikut të çënimit të të drejtave të tij.

Domosdoshërisht pozita më e favorshme e tregtarit në kontratat konsumatore të cilat për nga natyra janë kontrata unilaterale shmangin njohjen e plotë dhe të saktë të konsumatorit rreth efekteve që krijojnë kushtet në përmbajtje të kontratës ,arsye për të cilën edhe Direktiva<sup>69</sup>ka përcaktuar si evidentim të kushti dhe përcaktimin e tij si të padrejtë në rastin kur pasoja juridike që kushti i kontratës konsumatore përmban krijojnë pabarazi vetëm në të drejta dhe detyrime mes palësh, gjithashtu kërkohet që kjo asimetri në të drejta dhe detyrime të krijoj për konsumatorin dëm dhe në këtë rast në respektim të parimit të së drejtës civile dëmi që mund ti vij konsumatorit duhet të përlllogaritet duke pasur parasysh dëmin real dhe fitimin e munguar<sup>70</sup> që konsumatori ka pësuar

---

<sup>68</sup>Aktgjykimi i Gjykatës së 27 qershorit 2000. - Océano Grupo Editorial SA v Rocio Murciano Quintero (C-240/98) dhe Salvat EDITORES SA José,M. Sánchez Alcón Prades (C-241/98), José Luis Copano Badillo (C-242 / 98), Mohamed Berroane (C-243/98) dhe Emilio Viñas Féliu (C-244/98),paragrafi 24,26 i vendimit.

<sup>69</sup> Neni 3/1 e Direktivës 93/13/KEE.

<sup>70</sup> Neni 640,641,642 i Kodit Civil të RSH.

kjo për shkak të aderimit në kontratën konsumatore si dhe firmosjen e saj kjo pa qënë në njohje të plotë të kushteve të kësaj kontrate(element i natyrshëm i kontratve unilaterale),diraktiva është e qartë në përcaktimin e pasojave që mund të vijjnë konsumatorit nga hartimi në mënyrë të njëanshme të kontratës konsumatore si dhe firmosja pa njohu ose pa i dhënë kohë konsumatorit që të mund të kuptoi efektet e kushteve të kontratës konsumatore.

Por a përcakton Kodi Civil parime bazë rreth kushteve të padrejta të cilat sjellin pabarazi në të drejta dhe detyrime duke passjell për konsumatorin dëm?Në rast të lidhjes së kontratës me objekt të ligjshëm në bazë të Kodit Civil kërkohet që palët të përfitojnë në mënyrë të barabartë si në të drejta dhe detyrime ,arsye për të cilën edhe lidhet një kontratë kjo për të sjell për të dyja palët përfitime të ndërsjellta si në të drejta ashtu edhe detyrime kjo për të shmangur pabarazinë mes palësh,madje pikërisht për shmangien e këtij efekti është përcaktuar se “Janë të pavlefshme kushtet e përgjithshme që sjellin një humbje ose dëmtim të shpërpjesëtuar të interesave të palës kontraktuese, posaçërisht kur ato ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga parimet e barazisë e të paanësisë[...]”<sup>71</sup>kjo përbën një garanci në respektimin e barazisë së palëve në të drejta dhe detyrime kontraktuale,kjo në respektim të parimeve thelbësore kontraktuale,duke sanksionuar me pavlefshmëri absolute kushtet të cilat sjellin jo vetëm dëm por edhe humbje të palës ,duke devijuar nga parimi i barazisë<sup>72</sup> ,Kodi ka shkuar edhe më tej duke përcaktuar edhe moscënimin e parimit të paanësisë mes palësh kjo për të garantuar efekte sa me të drejta kontraktuale mes palëve ,element të cilin nuk e gjejmë në ligjin për mbrojtjene konsumatorit.

Nga ana tjetër neni 27 pika 1 i Ligji nr:9902/2008”Për mbrojtjen e konsumatorëve”i ndryshuar,ka përcaktuar në vlerësimin e kushtit të padrejtë se është pikërisht pabarazia që ky kusht shkakton në të drejta dhe detyrime mes palësh çka i sjell konsumatorit dëm,i cili në bazë të ligjit është një dëm i padrejtë i cili duhet shmangur,pra sikurse vihet re ligji fokusohet thelbësisht në efektet e kushtit të padrejtë dhe në respektim edhe të Direktivës parashikon si cënim për konsumatorin kushtin i cili ka efekt vetëm pabarazinë në të drejta dhe detyrime kundrejt konsumatorit duke mos parashikuar si cënim edhe parimin e paanësisë në kontratën konsumatore.

---

<sup>71</sup> Neni 686 /2 i Kodit Civil.

<sup>72</sup> Semini.M-E Drejta e detyrimeve-Tiranë-2006.

Krahas pabarazisë ligji kërkon që ajo të jetë e *ndejshme* dhe e *dallueshme* terma që në praktikë kërkojnë përkufizim kjo për të lehtësuar aplikimin, konkretisht me pabarazi të ndjeshme në të drejtat dhe detyrimet e palëve, do të kuptojmë faktin se kontrata nuk ka reciprocitet në të drejta dhe detyrime çka në praktikë konkludohet se tregtari fiton nga kontrata më shumë favore dhe të drejta në dëm të konsumatorit ,dhe nga ana tjetër konsumatorit mund ti shkaktohen një sër detyrimesh të cilat janë jo në proporcion me të drejtata e tregtarit.

Por si mund të vlerësohet dëmi që i vjen konsumatorit nga kontrata në shkeje të të drejtave të tij?Kjo mund të realizohet duke analizuar dy situata një faktike (pra situatë ku ndodhet konsumatori nën efektet e kontratës konsumatore) dhe situatës ku kontrata mungon dhe për këtë marrëdhënia rregullohet nga ligj ,nga kjo analizë do të përcaktohet dhe vlerësohet dëmi i shkaktuar konsumatorit ,por jo vetëm një tjetër mënyrë është duke evidentuar edhe përfitimin që tregtari ka arritur në saj të kësaj kontrate me kusht të padrejt ,kjo duke e krahasuar këtë fitim me fitimin në mungesë të kontratës por në aplikim të ligjit a do të rezultonte i njëjti përfitim?Në këtë kontekst Gjykata e ka më të thjeshtë të bëjë evidentimin e dëmit .

Të dyja këto kritere janë të vlerësueshme pikërisht duke gjykuar gjëndjen e konsumatorit në mungesë të kësaj kontrate ,dhe në zbatim të ligjit a do të pësonte konsumatori dëmin e shkaktuar dhe nëse ky dëm ka sjellë efekte domosdoshmërisht kjo është derivat i kushtit të padrejtë i cili ka shkaktuar pabarazi të ndjeshme dhe të dukshme pra vlerësimi i këtyre kritereve është vlerësim objektiv nga institucionet administrative ose gjyqësore,dhe jo subjektiv ,kërkohet objektivitete rreth efekteve të pabarazisë i bazuar në prova material dhe krahasime objektive,pra është një vlerësim i gjëndjes ekonomike dhe juridike të konsumatorit përpara dhe pas nënshkrimit të kontratës<sup>73</sup>

Por duhet theksuar se ligji nuk bën një përcaktim të qartë të mënyrës në mënyrë të detajuar se si do të përlloraget dëmi që i shkaktohet konsumatorit nga cënimi i të drejtave të tij pasojë e aplikimit të një kushti të padrejtë i cili krijon pabarazi mes palësh në kontratat konsumatore ,arsye për të cilën në këtë rast do të aplikohen rregullat e përcaktuara në Kodin Civil<sup>74</sup> rreth shkaktimit të dëmit ku shprehimisht Kodi përcakton se përlloragetja do të realizohet duke evidentuar dëmin e shkaktuar dhe fitimin e munguar që ka pësuar konsumatori,Kodi ka përcaktuar njëkohësisht edhe përlloragetjen e shpenzimeve të kryera në mënyrë të arsyeshme të cilat kanë qenë të nevojshme

---

<sup>73</sup> Çështja Alvarez C-226/12 ,16 January 2014.

<sup>74</sup> Neni 640 Kodi Civil i RSH.



për të përcaktuar përgjegjësinë si dhe masën e dëmit, gjithashtu edhe shpenzimet e kryera për shpërblimin e dëmit në rrugë jashtë gjyqësore.

-Jurisprudenca e GJED-së rreth kushti të padrejtë që passjell pabarazi në të drejta dhe detyrime mes palësh në dëm të konsumatorëve

Gjykata Europiane e Drejtësisë në jurisprudencën e saj ka përcaktuar interpretimin më të sakt të kësaj klauzole në përmbajtje të Direktivës në çështje në të cilat është mbajtur qëndrimi i mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve kundrejt pozicionit juridik asimetrik të tij në raport me tregtarin ,madje Gjykata në raport me zbatueshmërinë e Direktivës i ka dhënë të drejtë Gjykatave kombëtare që të mund të zbatojnë legjislacionin e brendëshëm rreth interpretimeve të koncepteve juridike të përcaktuara në këtë direktive.

Konkretisht Gjykata përcaktoi “*se Neni 3 (1) i Direktivës 93/13 mbi kushtet e padrejta në kontratat e konsumatorëve duhet të interpretohet si më poshtë:*  
- *koncepti i 'mosbalancimit të konsiderueshëm', në dëm të konsumatorit, duhet të vlerësohet në dritën e një analize të rregullave të së drejtës kombëtare të zbatueshme në mungesë të ndonjë marrëveshjeje ndërmjet palëve, për të përcaktuar nëse dhe deri në çfarë mase, kontrata e vendos konsumatorin në një situatë ligjore më pak të favorshme sesa ajo e parashikuar nga ligji kombëtar në fuqi. Për këtë qëllim duhet të kryhet edhe një vlerësim i gjendjes ligjore të atij konsumatori duke pasur parasysh mjetet në dispozicion të tij, sipas ligjit kombëtar, për të parandaluar përdorimin e vazhdueshëm të kushteve të padrejta;*  
- *në mënyrë që të vlerësojë nëse mosbalancimi lind në kundërshtim me kërkesat e mirëbesimit, duhet të përcaktohet nëse tregtari, mund të supozojë në mënyrë të arsyeshme se konsumatori do të kishte rënë dakord për afatin në fjalë në negociata individuale të kontratës.*

*Neni 3 /3 i Direktivës 93/13 duhet të interpretohet si kuptim që shtojca në të cilën kjo dispozitë i referohet, përmban vetëm një listë indikative dhe jo-shtruese të kushteve që mund të konsiderohen si të padrejta.*  
*Për më tepër, neni 4 /1 i kësaj Direktive parashikon që padrejtësia e një termi kontraktues duhet të vlerësohet duke marrë parasysh natyrën e mallrave ose shërbimeve për të cilat është lidhur kontrata dhe duke iu referuar, në kohën e lidhjes së kontratës , për të gjitha rrethanat që ndjekin*

*përfundimin e saj. Nga kjo rrjedh se, në lidhje me këtë, duhet të merren parasysh edhe pasojat e atij afati sipas ligjit të zbatueshëm për kontratën, duke kërkuar që t'i kushtohet vëmendje sistemit kombëtar ligjor.”<sup>75</sup>*

Konkluzioi i Gjykatës është përcaktues në dhënien të drejtë legjislacionit të brendëshëm për përcaktimin e kushteve për vlerësimin e dëmit të ardhur konsumatorit duke bërë një analizë të kushteve financiare të konsumatorit përpara dhe pas *iuris momentum* të lidhjes së kontratës konsumatore ,kjo për të arritur në një konkluzion sa më real dhe në përputhje me kushtet e konsumatorit kjo pasi nëse kjo analizë do të mungoi është evident fakti se mund të kemi abuzim të konsumatorit në raport me të drejtat që Direktiva i ka njohur duke pretenduar të drejta dhe çënim të barazisë edhe në rastin kur tregtari ka respektua ligjin dhe *de facto* nuk ka krijuar pabarazi në të drejta dhe detyrime me pasoje demin e konsumatorit.

Arsye për të cilën edhe Gjykata ka theksuar rëndësinë e kryerjes së një analize të kushteve financiare të konsumatorit përpara dhe pas lidhjes së kontratës, një analizë e tillë krahasuese do ti mundësojë gjykatës kombëtare për të vlerësuar dhe, siç mund të jetë rasti, deri në çfarë mase, kontrata e vendos konsumatorin në një situatë juridike më pak të favorshëm sesa ai i dhënë nga ligji kombëtar në fuqi. Aresye për të cilën, për këtë qëllim, duhet të kryet një vlerësim i situatës ligjore të atij konsumatori duke pasur parasysh mjetet në dispozicion të tij, sipas legjislacionit kombëtar, për të parandaluar përdorimin e vazhdueshëm të termave të padrejta<sup>76</sup>

### *2.2.3.Mirëbesimi në kushtin e padrejtë kontraktual*

Në kontratat konsumatore mirëbesimi përbën elementin e natyrshëm të këtyre kontratave kjo pasi në të kundërt këto kontrata nuk do të konsideroheshin më unilaterale por bilaterale,elementi i mirëbesimit krijonë gjithashtu mundësinë e një qarkullimi sa më të shpejtë të mallit duke shmangur afatet kohore të nevojshme për lidhjen e një kontrate,ç’ka edhe vonon lëvizjen e mallrave ,Direktiva ka përcaktuar prezencën e mirëbesimit në kontratat konsumatore duke krijuar edhe kushte ligjore të nevojshme për mos abuzimin me kontratat konsumatore konkretisht Direktiva

---

<sup>75</sup> Case C-415/11 Mohamed Aziz v Caixa d’Estalvis de Catalunya, Tarragona i Manresa (Catalunyacaixa)

<sup>76</sup> Case C-415/11 Mohamed Aziz v Caixa d’Estalvis de Catalunya, Tarragona i Manresa (Catalunyacaixa):C:2013: 164, paragrafi 68

përcakton se kontrata në kudërshtim me kërkesat e mirëbesimit shkakton tek konsumatori pabarazi domethënëse në të drejtat dhe detyrimet duke sjellë kështu një dëm për konsumatorin, pra sikurse konstatohet prania e mirëbesimit krijon kushtet që tregtari të mund të aplikoi kushte të cilat janë në cënim të të drejtave të tij arsye për të cilën kërkohet edhe mbrojtje në rast të aplikimit të kushteve të padrejta të pranuar në mirëbesim nga konsumatori.

Mirëbesimi është një element përbërës i kontratave dhe sidomos i kontratës së konsumatorit ku konsumatori mbart me vete prirjen për të mirëbesuar tregtarin kjo pasi konsumatori ka domosdoshmëri mallin shkak për të cilin mirëbesimi është sjellje e natyrshme e konsumatorit, në kahun tjetër tregtari mbart dëshirën për të përfituar edhe kur është në shkelje të të drejtave të konsumatorit duke abuzuar me mirëbesimin e tij.

Por çfarë efektesh mbart mirëbesimi si një kriter për konstatimin e kushtit të padrejtë? Mirëbesimi në kontratat konsumatore mbart nevojën për vlerësimin *real* dhe mbrojtjen duke i mirëpërcaktuar në kontratë interesat e konsumatorit nga ana e tregtarit. Pra, tregtari duhet të sillet gjatë aktivitetit të tij tregtar në përputhje me zakonet e mira tregtare, duke evituar praktikatat e padrejta tregtare.<sup>77</sup>

Vlerësimi nëse një kusht kontraktual është në përputhje me kërkesat e mirëbesimit duhet analizuar nëse tregtari, duke ndërvepruar në mënyrë të drejtë e të paanshme me konsumatorin, mund të prezumojë në mënyrë të arsyeshme se konsumatori do të kishte rënë dakord me një kusht të tillë në negociimet kontraktore individuale, pra përfshirja e interesave të konsumatorit në kontratë kjo duke vetëvendosur pozicionin e tregtarit në atë të konsumatorit, pra kërkohet një sjellje e paramenduar e tregtarit në mbrojtje të konsumatorit<sup>78</sup>.

Përveç këryre kushteve me rëndësi dytësore paraqitet edhe lloji i mallrave ose shërbimeve, për të cilat është lidhur kontrata, kushtet aksesore në të cilat është lidhur kontrata si mund të jetë publiciteti mashtrues apo koha e lidhjes së kontratës, këto elemente duhet të merren në konsideratë për të vlerësuar nëse në tërësinë e saj marrëdhënia midis konsumatorit dhe tregtarit është e ekuilibruar në të drejta dhe detyrime .

---

<sup>77</sup> Unfair contract terms guidance- Guidance for the Unfair Terms in Consumer Contracts-Regulations-1999-September-2008

<sup>78</sup> The Unfair Terms in Consumer Contracts Regulations-Research Paper 96/93-15 ,October-2006.London-UK.

Në fakt analiza e mirëbesimit është parë në këndvështrime të ndryshme si në sistemin *common law* edhe në atë *civil law* konkretisht në sistemin Gjerman ashtu edhe në atë Britanik (nëse do të krahasojmë) në sistemin Gjerman nocioni “mirëbesim” derivon më shumë nga kultura dhe historia e tyre dhe në praktikë ka vetëm njohurin në tërësi të sendit ndërkohë në sistemin Britanik kuptimi është më i gjerë dhe rëndësia e tij shpesh sanksionohet me pavlefshmëria relative të veprimit juridik në rastin konkret në kontratën konsumatore,ky nocion përfshin jo vetëm përgjegjshërinë ,por gjithashtu edhe ndërgjegjshërinë ,dhe ndershmërinë ,por edhe pse në sistemin *common law* mirëbesimi është i përcaktuar shprehimisht dhe i sanksionuar në rast mungese të tij ,në sistemin civil law(sistemi gjermanik)ky nocion është më i ngushtë dhe më sipërfaqësorë.

Parimi i mirëbesimit përbën njëkohësisht edhe një parim thelbësor civil Kodi Civil përcakton se palët gjatë zhvillimit të bisedimeve për hartimin e kontratës duhet të sillen me mirëbesim ndaj njëri-tjetrit<sup>79</sup> domosdoshmërisht kjo duhet edhe të reflektohet edhe në kontratat konsumatore.

Nocioni i mirëbesimit në thelb përbën një kërkësë morali dhe ndërshmërie në hartimin e kushteve të kontratave në përgjithësi dhe të kontratave konsumatore në veçanti,kjo me qëllimin e mosdëmtimit të palës tjetër e cila nuk është në djeni të plotë të kushteve të kontratës ose nuk kishte pasur mundësi objektive për të qënë në djeni të plotë të këtyre kushteve ,kjo për shkak të natyrës juridike të kontratave konsumatore,përcaktimi i mirëbesimit dhe shkelja e tij në kontratat konsumatore pavarësisht faktit se si kriteri mbete subjektiv ,kërkon një përcaktim dhe një përkufizi ligjor dhe objektiv të zbatimit dhe evidentimit në praktikë se në cilat raste objektivisht kemi të bëjmë me cënim të parimit të mirëbesimit në kontratat konsumatore,pra përcaktimit të *regu lae iu ris* për të garantuar një zbatim sa më të saktë të këtij parimi<sup>80</sup>.

Konkretisht elementët objektiv të cilët do të trajtohen si kriterë për vlerësimin e mirëbesimit janë:  
*-palët duhet të kenë njohje të elementëve thelbësorë të kontratës veçanërisht konsumatori;*  
*-një kontakt i mjaftushëm mes palësh të cilët do të firmosin kontratën duke diskutuar kushtet esenciale të kontratës;*

---

<sup>79</sup> Neni 674 Kodit Civil R.SH.

<sup>80</sup> fr . sop r a ttu tto BIANCA, La nozione di buona fede quale comportamento con -trattuale, in R iv . Dir. Civ , 1983, I, p . 205 ss.; MENGONI, Appunti per una teoria del-le clausole generali, in Il principio di buona fede, Milano, 1987, fq 17.

*-përrjashtohet mundësia e tërheqjes në rast të njohjes dhe diskutimit të kushteve thelbësore kontraktuale;*

*-ka mundësi për tërheqje nga kontrata nëse pala është tërhequr në firmosje në rastin kur i është thënë se kjo kontratë është e zakonshme duke i vesuar vullnetin;<sup>81</sup>*

Domosdoshmërisht vlerësimin e mirëbesimit do të duhet që ta realizoi Gjykata e cila duhet të bëjë një vlerësim objektiv të këtij parimi në rast të cënimit të tij, duke ruajtur dhe respektuar integritetin e palës tjetër, element që Gjykata duhet ta vlerësoi objektivisht parimin, në mungesë të pranisë së këtij elementi në kontratë efekti është cënimi i mirëbesimit.

Njëkohësisht një element i rëndësishëm në vlerësimin e mirëbesimit është edhe përpjekja e tragtarit për të garantuar mbrojtje të konsumatorit kundrejt cënimit të të drejtave të tij kjo nëpërmjet informimit të konsumatorit paraprakisht për çdo ndryshim të kushteve të mundshme kontraktuale të cilat janë të pamundura për tu parashikuar në momentin e lidhjes së kontratës, respektimi i të drejtës së informimit të konsumatorit për çdo ndryshim të mundshëm si dhe përfshirja në kontratën konsumatore të një garancie në rast të dëmit të konsumatorit të ardhur nga ndryshimi i kushteve dhe rrethanave kontraktuale, përbën një tregues thelbësor për tregtarin në respektim të mirëbesimit si dhe një garanci procedurale për të konstatuar qëllimin real të tregtarit për të siguruar mbrojtjen e konsumatorit kundrejt dëmeve të ardhura si rrjedhojë e ndryshimeve të kushteve kontraktuale.

*-Jurisprudenca e GJED-së rreth kërkesë së mirëbesimit në kontratat konsumatore.*

Gjykata Europiane ka përcaktuar praninë e mirëbesimit si një element esencial dhe thelbësor në mbrojtjen e konsumatorit kundrejt kushteve të padrejta në fakt Gjykata ka kushëzuar vlerësimin e cënimit të mirëbesimit si parim thelbësor kontraktual vetëm më efektin e pabarazisë në të drejta dhe detyrime i cili shkakton tek konsumatori një dëm kontraktual, në mungesë të këtyre efekteve mirëbesimi do të ishte i pakonstaueshëm dhe për pasojë edhe i pa sanksionueshëm.

---

<sup>81</sup> IL DOVERE DI BUONA FEDE E L'ABUSO DEL DIRITTO - Francesco GALGANO-1994-Tivoli.

Gjykata ka përcaktuar se garantimi i konsumatorit kundrejt çdo ndryshimi kontraktual të kushteve kontraktuale do të duhet që të shoqërohet me praninë e një garancie kontraktuale kjo në respektim të parimit të mirëbesimit ,kjo pasi një ndryshim i kushteve kontraktuale domosdoshmërisht shoqërohet edhe me dëme kundrejt konsumatorëve , kjo pasi nuk janë të pakta rastet kur konsumatori për shkak të ndryshimeve të rrethanave ose të mungesës së informimit rreth ndryshimeve potenciale të kushteve kontraktuale sidomos në kontratat e kreditit ,shoqërohet me pasojën e pabarazisë në të drejta dhe detyrime të konsumatorit duke sjell për të një dëm kontraktual,pikërisht për të shmangur këto efekte Gjykata ka përcaktuar detyrimin e vendosjes së një garancie kontrale kjo duke garantuar të drejtën e informimit të konsumatorit në rast të pranisë se këtyre ndryshimeve<sup>82</sup>.

Gjykata ka theksuar se kriteri i mirëbesimit është elementi që garanton vënien në efikasitet të kontratave konsumatore,si dhe siguron që këto praktika të mund të zbatohen duke garantuar lehtësirë në qarkullimin civil të çdo malli.

### *2.3. Mbrojtja kundrejt kushteve të padrejta*

Në të drejtëm konsumatore mbrojtja e konsumatorit kundrejt kushteve të padrejta në legjislacionin e BE-së mbart një rëndësi thelbësore arsye për të cilën edhe Direktiva ka përcaktuar kushte si mund të garantohet mbrojtja e konsumatorit kundrejt kushteve të padrejta ,fillimisht Direktiva ka vendosur në mënyrë përshkruese një sër rastesh të cilat do të konsiderohen si raste të kushteve të padrejta në kontratat konsumatore<sup>83</sup> kjo për ti dhënë mundësi shteteve anëtare të mund të përfshinë këto raste por edhe raste të tjera të cilat do ti konsiderojnë si shkelje të të drejtave të konsumatorit.

Gjithashtu Direktiva për të garantuar vendosjen e parimeve bazë të cilat do të duhet që shtetet anëtare të mund ti zbatojnë ka përcaktuar detyrimin e shteteve anëtare që të bëjë vlerësimin e kushteve të padrejta në kontratat konsumatore duke shqyrtuar natyrën e mallrave kjo duke i lënë

---

<sup>82</sup> Case C-415/11 Mohamed Aziz v Caixa d'Estalvis de Catalunya, Tarragona i Manresa (Catalunyacaixa):C:2013

<sup>83</sup> Aneksi 1 i Direktivës 93/13/KEE.

hapsirë shteteve që të mund të përcaktojnë kushte dhe raste të tjera kundrejt të cilave konsumatorët do të duhet që të mbrohen<sup>84</sup>.

Ndërkohë në bazë të ligjit për mbrojtjen konsumatore konsumatori (të vitit 2008) gëzon *ipso jure* mbrojtje kundrejt kushteve të cilat janë vendosur në kontratë , në kushtet kur (në respektim edhe të kushteve të Direktivës) më parë këto kushte nuk kanë qenë të negociuara por kontrat është firmosur nga konsumatori në mirëbesim dhe në padije të kushteve të cilat preknin të drejtat e tij si konsumator.

Por si realizohet mbrojtja e konsumatorit kundrejt kushteve të padrejta sipas Direktivë dhe ligjit shqipëtarë? Mbrojtja derivon pikërisht nga prezumimi i të qënurit *kontrata standarte* ku gjithashtu prezumohet fakti se konsumatori nuk ka qenë pjesë aktive e negocimit dhe hartimit të kushteve të kontratës konsumatore ,për pasojë kontrata është firmosur në mirëbesim të plotë ,arsye për të cilë edhe ligji për mbrojtjen konsumatore në këto raste në rastin e paraqitjes së pretendës nga ana e konsumatorit kjo si në institucionet administrative ashtu edhe në ato gjyqësore ja nënshton procedurës së rishikimit të kushteve të kontratës dhe verifikimit të qënies apo jo të drejta kushtet e përcaktuara në kontratën konsumatore,kjo procedurë mbart me vete edhe detyrimin ligjor të evidentimit (nga ana e insitucionit që shqyrton kushtet) të pasojave që sjell nënshkrimi i një kushti të padrejtë nga ana e konsumatorit.

Një rast tipik në të cilën Gjykata ka marë në shqyrtim kushtet kontraktuale dhe është shprehur rreth faktit nëse këto kushte kanë qenë të drejta ose të padrejta është rasti i Unicaja Banco SA<sup>85</sup> në të cilën Gjykata vendosi se” *ekzaminimi i padrejtësisë së mundshme të një afati të një kontrate të lidhur midis një shitësi ose furnizuesi dhe një konsumatori kërkon që ajo të përcaktohet nëse ky afat shkakton një çekuilibër të konsiderueshëm në të drejtat dhe detyrimet e palëve sipas një kontrate në dëm të konsumatorit[....]është detyrë e gjykatës referuese, ndër të tjera, të krahasojë mënyrën e llogaritjes së normës së interesit të zakonshëm të përcaktuar në atë afat dhe shumën aktuale që rezulton nga ajo normë me metodat e llogaritjes të përdorura në përgjithësi, normën e interesit ligjor dhe normat e interesit të aplikuara në treg në datën e përfundimit të marrëveshjes*

---

<sup>84</sup> Neni 4 i Direktivës 93/13/KEE

<sup>85</sup> C-482/13, C-484/13, C-485/13 dhe C-487/13

*në fjalë në procedurën kryesore për një hua me një shumë dhe afat të krahasueshëm me ato të marrëveshjes së huasë në shqyrtim;*

*- sa i përket vlerësimit nga një gjykatë kombëtare për padrejtësinë e mundshme të afatit lidhur me shlyerjen e përshpejtuar që rezulton nga dështimi i debitorit për të përmbushur detyrimet e tij gjatë një periudhe të caktuar të kufizuar, gjykata referuese duhet të shqyrtojë nëse e drejta e shitësit ose furnizuesit për të kërkuar totalin e kredisë është e kushtëzuar nga mospërmbushja nga ana e konsumatorit të një detyrim i cili ka rëndësi thelbësore në kontekstin e marrëdhënies kontraktuale në fjalë, nëse kjo e drejtë parashikohet në rastet në të cilat një mos-pajtueshmëri e tillë është mjaft serioz në dritën e afatit dhe shumës së huasë, pavarësisht nëse kjo e drejtë derogon nga rregullat e aplikueshme të së drejtës së zakonshme, kjo kur mungojnë dispozita specifike kontraktuale dhe nëse ligji kombëtar parashikon mjete adekuate dhe efektive duke bërë të mundur që konsumatori t'i nënshtrohet një termi të tillë për të korrigjuar efektet e huasë”<sup>86</sup>* pikërisht në këtë rast Gjykata ka marrë në shqyrtim një nga çështjet kur një kusht kontraktual si afati përbën një shkelje të të drejtave të konsumatorit dhe për pasojë një kushtë të padrejt për tu përdorur në kontratat konsumatore, arsye për të cilën edhe Direktiva ka kërkuar qartësimin e kushteve të cilat do të konsiderohen të padrejta në kontratat konsumatore, kjo për të shmangur përsëritjen e vazhdueshme të këtyre kushteve si dhe shmangien e një investimi të paarsyeshëm të strukturave ligjzbatuese, si dhe ato gjyqësore në shqyrtimin e kushteve për të cilat ekziston një shqyrtim administrative apo gjyqësore i cili ka konkluduar në një vendim rreth kushteve të caktuara të përdorura në kontrata të ndryshme.

Gjithashtu në mbrojtje të të drejtave të konsumatorit Direktiva dhe ligji kërkon që kushti nuk duhet të jetë negociuar individualisht ndërmjet palëve përpara firmosjes, por duhet të jetë ofruar i gatshëm nga tregtari dhe të jetë nënshkruar nga konsumatori.

Kjo është një mbrojtje që ligji për mbrojtjen e konsumatorit i ka ofruar konsumatorit kjo pasi ndodhemi përpara kontratave të cilat janë hartuar dhe i janë ofruar të gatshme konsumatorit për nënshkrim, duke përjashtuar plotësisht konsumatorin nga procedura e negociimit të kushteve kontraktuale, dhe madje duke e shpërqëndruar dhe sugjestiuar konsumatorin edhe kundrejt vullnetit të tij për njohjen e kontratës përpara firmosjes, duke e përqëndruar vëmendjen vetëm tek procedura e firmosjes së kontratës, kjo pa marrë parasysh edhe të drejtën e konsumatorit për ankimi

---

<sup>86</sup> Po aty



,çka e bënë edhe më të lehtë për tregtarin shitjen e produktit ose shërbimit, si dhe dëmtimit të interesave të konsumatorit.

Por gjithashtu duhet njohur domosdoshmëria e legjitimit të kontratave konsumatore kjo pasi krijojnë kushte të favorshme për kursim kohe dhe kosoje si për tregtarët ashtu edhe për konsumatorët, por *post factum* të lehtësirave që krijon, në thelb kontrata konsumatore mbart domosdoshmërinë për vendosjen e ekuilibrit midist të drejtave dhe detyrimeve si të tregtarit ashtu edhe të konsumatorit.

Duhet theksuar se Direktiva përbën një bazë të efektshme ligjore si dhe përbën një udhrrëfyes me rëndësi thelbësore për shmangien e aplikimit të kushteve të cilat mbartin cënime të të drejtave të konsumatorit ,gjithashtu edhe ndihmon shtetet anëtare të mund të hartojnë akte ligjore apo nënligjore kjo për të transpozuar Direktivën apo për të implementuar direkt këtë Direktivë në aktet e rëndësishme me qëllim njohjen edhe të tregtarëve të kushteve të cilat nuk duhet të jenë pjesë e kontratave të tyre kjo pasi do të shoqërohet me sanksione të ndryshme në varësi të parashikimeve të përcaktuar nga secili shtet.

Gjykata kundrejt pengesës së aplikimit në mënyrë të vazhdueshme të kushteve të padrejta në kontratat konsumatore ka përcaktuar se” *kërkon(Gjykata) që Shtetet Anëtare të sigurojnë mjete adekuate dhe efektive për të parandaluar përdorimin e vazhdueshëm të kushteve të padrejta në kontratat e lidhura me konsumatorët nga shitësit ose furnitorët*”<sup>87</sup> mbi bazën e këtij vendimi është parë e nevojshme nga shtete anëtare që të mund të bëjnë amendimet e nevojshme në legjislacionin e brendshëm për të shmangur abuzimin më kushtet e pa drejta në kontratat konsumatore.

#### *2.4. Kushtet e padrejta shprehimisht të përcaktuara në ligj*

Një sër kushtesh të padrejta ligji për mbrojtjen konsumatore i ka përcatuar shprehimisht duke lehtësuar kështu operimin e tregtarit në treg duke i dhënë atij mundësinë e vlefshmërisë së

---

<sup>87</sup> Banco Español de Crédito, EU: C : 2012: 349, paragrafi 68,

kontratës nëpërmjet respektimit literal të ligjit ,çka do të thotë në praktikë mospërfshirje të atyre kushteve të cilat vetë ligji në menyrë eksplicite i ka përcaktuar si kushte të padrejta.

Por duhet theksuar se kjo listë e përcaktuar në nenin 27 pika 4 e ligjit për mbrojtjen e konsumatorit viti 2008 nuk është një listë shteruse ,kjo edhe për vetë faktin se zhvillimi i tregtisë dhe inovacioni është gjithmon në zhvillim dhe një përcaktim shterues do ta bënte ligjin për kushtet e papërmendura të pazbatueshëm,edhe pse në këtë rast institucionet administrative apo gjyqësore do tju duhej të bënin një interpretim zgjerues të kushteve të padrejta thelbësore mbi bazën e të cilave do të mund të gjykohej shkelja e të drejtave konsumatore,kjo për shkak të kushteve të padrejta.

### *2.5.Transparenca në kushtet kontraktore dhe Direktiva 93/13/KEE*

Në mbrojtjen e të drejtave konsumatore luan një rol të rëndësishëm transparenca në mënyrën e hartimit të kushteve konsumatore,kjo pasi është i qartë fakti se në kontratat konsumatore kushtet janë të hartuara nga njëra palë dhë pala tjetër nuk është aktive në negocimin e kushteve kontraktuale,arsye për të cilën edhe direktiva ka vendosur disa kriteret minimale të cilat shtete anëtare duhet ti implementojne në legjislacionin e tyre në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve kundrejt efekteve të kushteve të cilat janë të padrejta në raport me konsumatorin,dhe efekti i të cilave është pikërisht pabarazia në kontratat konsumatore.

Direktiva ka përcaktuar se hartimi i kushteve në kontratat konsumatore duhet të jetë i thjeshtë dhe i kuptueshëm<sup>88</sup> për çdo konsumator ,kjo për të rritur shkallën e ndërgjegjshmërisë së konsumatorit në momentin e firmosjes së kontratës,gjithashtu edhe për të kaluar përgjegjësin tek konsumatori kjo në rast pretence të efekteve të padrejta që mund të ketë kontrata e cila ka respektuar kriterin e kuptueshmërisë si dhe qartësië në raport me konsumatorin.

Gjithashtu Direktiva ka përcaktuar si një element të domosdoshëm ku nevojitet transparenca nga tregtari është pikërisht *afati* ku Direktiva në rastin kur afati i kontratës nuk paraqitet i qartë apo i kuptueshëm atëherë ai do të interpretohet në favor të konsumatorit kjo me përjashtim të

---

<sup>88</sup> Neni 5 i Direktivës 93/13/KEE.

proceduarve të përcaktura në nenin 7/2 të Direktivës<sup>89</sup>konkterisht Gjykata në këtë rast ka përcaktuar se “për sa i përket termit i cili është objekti i mosmarrëveshjes në procedurën kryesore, duhet patu parasysh se ,<sup>90</sup> në një kontrata e lidhur ndërmjet konsumatorit dhe shitësit apo furnizuesit brenda kuptimit të Direktivës, një afat, i hartuar paraprakisht nga shitësi ose ofruesi – i cili nuk ishte subjekt i negociatave individual - qëllimi i së cilës është që të japë juridiksion në lidhje me të gjitha mosmarrëveshjeve që dalin sipas kontratës në gjykatë në juridiksionin territorial të cilat shitësi ka vendin e tij kryesor të biznesit, plotëson të gjitha kriteret e nevojshme që ajo të gjykohet e padrejtë për qëllimet e Direktivës” gjithashtu edhe në vendimin Van Hove Gjykata ka përcaktuar se “në veçanti, padrejtësia e një afat të tillë mund të rezultojë nga një formulim që nuk është në përputhje me kërkesat e Direktivës e duke u hartuar në gjuhë jo të thjeshtë dhe jo të kuptueshme të përcaktuar në Nenin 5 të Direktivës 93/13 gjithashtu duke pasur parasysh pozitën e dobët të konsumatorit vis-à-vis të shitësit apo furnizuesit kjo në lidhje edhe me nivelin e tij të dijes,kërkohet nga Gjykata një interpretim i gjerë për të garantuar një mbrojtje sa më efëçente të komsumatorit”<sup>91</sup> pra sikurse vihet re Gjykata edhe në lidhje me një element të veçantë të kontratës konsumatore ka mbajtur qëndrim në mbrojtje të të drejtave të konsumatorit kjo në respektim të faktit që nuk është respektuar gjuha e thjeshtë dhe e kuptueshme në kontratën konsumatore ,gjithashtu duke ritheksuar edhe njëherë pozitën e “dobet” të konsumatorit në raport me atë të tregtarit.

Gjithashtu transparenca përjashton edhe termat të cilat për nga formulimi dhe përmbajtja mund të krijojnë paqartësi dhe konfuzion tek konsumatori elemente këto të cilat kanë si efekt aplikimin e kushteve të padrejta në kontratat konsumatore ,duke krijuar një gjëndje pabarazie mes palësh edhe në këtë rastë Gjykata është shprehur se” gjykata kombëtare konsideron se disa nga termat financiarë të shtypura në kontratën e kredisë janë të pavlefshme për shkak të mungesës së qartësisë dhe kuptueshmërinë. Kjo është e lidhur me përdorimin në formë të shtypur nga akorduesit e e kredisë të cilët kanë aplikur një forëm të veçantë reklamimi duke dhënë përshtypjen tek

---

<sup>89</sup> Neni 7/2 e Direktivës përcakton se” Mjetet e përmendura në paragrafin 1(të po këtij neni) duhet të përmbajë dispozita ku persona apo organizata, që kanë një interes legjitim sipas ligjit kombëtar në mbrojtjen e konsumatorëve, mund të marrin masa në përputhje me ligjin kombëtar në fjalë para gjykatave apo para organeve kompetente administrative për një vendim kundrejt kushtet kontraktuale të hartuara për përdorim të përgjithshëm janë të padrejta, në mënyrë që ata mund të aplikojnë mjete të duhura dhe efektive për të parandaluar përdorimin e vazhdueshëm të termave të tilla”

<sup>90</sup> Océano Grupo editoriale dhe Salvat EDITORES , paragrafët 21 deri 24,

<sup>91</sup> Van Hove , C -96/14, BE: C: 2015: 262, paragrafi 40

*konsumatori se transaksioni është pa pagesë, element i cili ka çorientuar konsumatorin[ ...] duhet vërejtur se, këto terma janë përcaktuar nga Gjykata kombëtare si terma të paqartë, dhe për pasojë në dëm të konsumatorit[ ...] megjithatë, këto terma duhet të plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 3 (1) të Direktivës, në mënyrë që të konsiderohen si të padrejta duhet që të mos kenë qënë negociuar individualisht, dhe duhet në kundërshtim me kërkesat e besimit të mirë, të shkaktojë një çekuilibër të rëndësishëm në të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontrata e palëve, në dëm të konsumatorit. “pra sikurse vihet re aplikimi i kushteve të cilat janë çorientuese krijon të njëjtin efekt si kushtet e padrejta si dhe i nënshtrohet të njëjtave kushte për vlerësimin nëse këto kushte çorientuese janë të padrejta apo nuk mund të konsiderohet të tilla.*

Transparenca në mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit mbart rëndësi thelbësore në kuptueshmërinë e konsumatorit kundrejt kontratës që po firmos, dhe për qartësim të plotë të konsumatorit për të drejtat dhe detyrimet në rastin kur ai do të nënshkruaj një kontratë konsumatore me tregtarin, një kontratë ku kushtet nuk janë transparente dhe për më tepër për nga objekti i kontratës konsumatore të cilën konsumatori e lidh për shkak nevojshmërie objektive, domosdoshmërisht kërkon mbrojtje nga ligji, kjo pasi në rastin e kushteve apo kritereve jotransparente duke mbajtur në mend edhe nevojën e konsumatorit për të lidhur këtë kontratë, këto janë premisa të cilat i krijojnë kushte të favorshme tregtarit për të abuzuar dhe për të mos qënë transparen kjo gjithmon duke pasur si qëllim maksimizimin e fitimit të tij kjo në shkeje të të drejtave dhe në dëm të plotë të konsumatorit.

Ligji shqiptarë kërkon grantimin e një gjuhe sa më të thejshtë (kjo në përputhje edhe me kërkesat e Direktivës) dhe të kuptueshme pa përmbajtte të shprehive teknike dhe shume profesionale në rastin kur këto kushte kontraktuale janë për konsumatorin i cili jo domosdoshmërisht duhet që të ketë njohuri rreth çdo terminologjie që mund të përdoret në kontratat konsumatore, arsye për të cilën edhe gjuha e përdorur duhet të jetë e *kuptueshme* si dhe e *dukshme* për konsumatorin kjo pasi duhet ti përshtatet nevojave të çdo konsumatori.<sup>92</sup>

---

<sup>92</sup> Plain intelligible language - The Scope of the Directive : Non-negotiated Terms in Consumer Contracts, Chairman : Thomas EILHELMSSON, Professor at the University of Helsinki

Ligji pikërisht për këtë arsye ka specifikuar llojin e formës së shkrimit i cili sipas ligjit duhet të jetë *Times New Roman*, çka është i kuptueshëm për çdo kategori konsumatorësh por edhe është forma e shkrimit që çdo akt ligjor dhe nënligjor përdore.

Element i cili i referohet madhësisë së karakterit të shkrimit i lehtë hapësirë për abuzim nga ana e tregtarit është shprehja që legjislatori ka përcaktuar në ligj e cila është “*me madhësi të karakterit të shkrimit, të paktën 10*” shprehja “*të paktën 10*” nuk është imperative por referuse dhe duhet theksuar se kjo madhësi jo nga shumica e konsumatorëve është lehtësisht e kuptueshme, kjo pasi në një interpretim gjyqësorë kjo shprehje duke mos përcaktuar në mënyrë imperative një kufi minimal të madhësisë së karakterit të shkrimit i lehtë hapësirë tregtarit që të mos ti qëndrojë këtij kriteri duke qënë se nga mënyra e formulimit të dispozitës kuptohet si një kërkesë referuse dhe jo detyruse, çka krijonë mundësinë për abuzime nga tregtari duke shkelur të drejtat e konsumatorit kjo në shkelje të transparencës, por ligji edhe në këtë rast ofron mbrojtje konsumatorit kjo në rastin kur ka dyshime rreth kushtit të kontratës, interpretimi do të jetë në favor të konsumatorit interesi i të cilit prevalon mbi ato të tregtarit.<sup>93</sup>

Në garantimin e të drejtave të konsumatorit ligji për mbrojtjen e konsumatorit neni 28 kërkon transparencë në kushtet konsumatore, kjo bëhet pikërisht me qëllimin që konsumatori në momentin juridik të nënshkrimit të kontratës, duhet të ketë të qarta kriteret të cilat po pranon si dhe detyrimet e tij si palë në kontratë, por krahas mbrojtjes konsumatore edhe tregtari është subjekti i cili me anë të transparencës në kushtet konsumatore garanton zhvillimin e aktivitetit të tij në kushte të drejta dhe të qarta si për konsumatorin ashtu edhe për tregtarin.

Kërkesa për transparencë në kushtet kontraktuale, dhe përcaktimi i këtij kriteri në ligj dhe jo në akt nënligjor siç mund të jetë një VKM tregon rëndësinë që mbart transparenca në kushtet kontraktuale.

Terësia e këtyre kushteve i jep mundësi, konsumatorit të parashikojë me siguri të gjitha pasojat ekonomike që i vijnë nga një kusht kontraktual, kjo pasi në rastin kur situata e konsumatorit është *post factum* dhe kontrata me kushte jo të qarta për konsumatorin është firmosur, e drejta për të hequr dorë nga kontrata nuk i balancon të drejtat e konsumatorit përkundërt tregtarit, në rast se e drejta e heqjes dorë është thjesht formale dhe konsumatori nuk ka ku të drejtohet tjetër për të marrë

---

<sup>93</sup> Neni 28/1 I ligjit nr:9902 dt:17.04.2008”Për mbrojtjen e konsumatorëve”indryshuar.

një shërbim jetik, gjithashtu instituti i heqjes dorë nga kontrata nuk realizon *restitution in integrum* çka realizohet vetëm me anë të zhvillimit të një procesi të rregullt gjyqësorë në respektim të ligjit procedural ashtu edhe materil.

*2.6. Efektet juridike të kushtit të padrejtë në kontratat konsumatore, siaps Direktivës 93/13/KEE, dhe ligjit për mbrojtjen konsumatore.*

Mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve edhe në rastin e efekteve të kushteve të padrejta ka rëndësi primare në raport me mbrojtjen e të drejtave të tregtarit, në fakt Direktiva nuk specifikon në mënyrë të qartë se cilat do të jenë efektet kundrejt konsumatorit por përcakton vetëm pavlefshmërinë e kërtje kushteve duke lënë në fuqi kontratën për pjesët e tjera të saj të cilat janë të zbatueshme dhe në respekt të akteve komunitare dhe kombëtare, konkretisht direktiva përcakton se” *shtetet anëtare do të përcaktojnë se kushtet e padrejta të përdorura në një kontratë të lidhur me një konsumator nga shitësit apo furnizuesit, siç parashikohet në legjislacionin e tyre kombëtar, **nuk do të jetë detyruese për konsumatorin** dhe se kontrata do të vazhdojë të jetë e lidhur midis palëve mbi këto terma në qoftë se ajo është e aftë për të vazhduar pa kushtet e padrejta.*” pra sikures vihet re Direktiva ka përcaktuar apriori se këto kushte të padrejta nuk do të jenë të detyrueshme për konsumatorin, dhe se kontrata midis palëve do të ketë efekte (nëse direktiva përcakton) ajo është *e aftë për të vazhduar edhe pa kushtet e padrejta*, pra nga përkufizimi që jep direktiva rreth efekteve juridike të kushteve të padrejta në kontratat konsumatore konstatohet se kushtet e padrejta nuk prekin vlefshmërinë juridike tërësore të kontratës pra ato nuk pasjellin pavlefshmëri absolute të veprimit juridik (që në rastin konkret është kontratat) kjo duke mbrojtur kontratën në tërësi si dhe duke lejuar vlefshmërinë ligjore të pjeshme të kontratës si dhe vlefshmërinë e pasojave juridike të pjesëve të tjera të kontratës të cilat nuk çënojnë të drejtat e konsumatorit, kjo për të garantuar që kontrata të mos konsiderohet *nul* në çdo element të saj por për të siguruar që ato element të cilat janë në respektim të ligjit dhe Direktivës të mund të jenë të vlefshme juridikisht dhe të mund të prodhojnë pasoja juridike.

Por në raport me hapsirën ligjore që ka garantuar Direktiva rreth vlefshmërisë së pjeshme të kontratës konsumatore në praktikë është paraqitur paqartësi rreth faktit nëse këtë pavlefshmëri të pjeshme të kontratës konsumatore mund ta “plotësoi” një vendim gjykate, është rasti në të cilën

gjkata mer në shqyrtim një kontratë konsumatore dhe zëvendëson kushtin e padrejt me një të drejt ,a ka të drejtë Gjykata të mund të zëvendësojë kushtin e padrejtë në kontratat konsumatore si dhe a do të garantoj gjykata zbatimin e institutit *restitution in integrum*? Gjykata në çështjen Pannon GSM Zrt. v Erzsébet Sustikné Gyorfi ka përcaktuar se”Neni 6 (1) të Direktivës së Këshillit 93/13 mbi kushtet e padrejta në kontratat e konsumatorëve duhet të interpretohet si kuptim që një kusht kontrktual i padrejtë nuk është detyruar për konsumatorin.

Qëllimi i nenit 6 të kësaj direktive, e cila është për të forcuar mbrojtjen e konsumatorit, nuk do të arrihet nëse konsumatori ishin vetë i detyruar për të ndikuar në padrejtësinë e kushteve kontraktuale.<sup>94</sup>

Gjykata kombëtare duhet të shqyrtoj, edhe kryesishtë, padrejtësinë e një term kontraktual ku ajo ka në dispozicion të saj elementet ligjore dhe faktike të nevojshme për këtë funksion. Kur ajo e konsideron një term i tillë të jetë i padrejtë, ai nuk duhet të jetë i aplikushëm.

Është për gjykatat kombëtare për të përcaktuar nëse një term kontraktual, plotëson kriteret për t'u kategorizuar si i padrejtë brenda kuptimit të nenit 3 (1) të Direktivës 93/13 mbi kushtet e padrejta në kontratat e konsumatorëve,por në këtë vlerësim gjykata nuk mund të zëvendësoi një kusht të padrejt me një të drejtë kjo kryesisht ,por Gjykata mund të limitohet vetëm në shpalljen e kushtit të padrejtë”pra sikurse vihet re Gjykata nuk mund të zëvendësoi rolin dhe detyrën e palëve në një kontratë konsumatore kjo pasi edhe nga pikpamja proceduriale detyra e gjykatës nuk është të zëvendësoi rolin e palëve në process por vetëm të shprehet rreth objektit të aktit objekt gjykimi në respektim edhe të parimit kushtetues të paanësisë së gjyqtarit në proces.

Ndërkohë në bazë të ligjit aktual<sup>95</sup> domosdoshmërisht një kusht i cili është i padrejtë dhe si i tillë është parashikuar nga ligji ai do të duhet të ketë efektet që ligji parashikon për një kusht i cili është në shkelje të ligji dhe në dëm të konsumatorit ,ligji parashikon pavlefshmëri të kushtit dhe nuk e detyron konsumatorin që ta respektojë atë,kjo edhe në përputhje edhe me Direktivën 93/13/KEE/.

Por efekti i pavlefshmërisë deri në cilin *iuris momentum* e shtrin efektin?Në bazë të ligjit pavlefshmëria e kushtit në shkelje të së drejtës së konsumatorit e shtrin efektin që nga momenti juridik i lidhes së kontratës ,pra ky konstatim ka fuqi prapavepruse që në momentin kur palët kanë

---

<sup>94</sup> Pannon GSM Zrt. v Erzsébet Sustikné Gyorfi ,*Shih par 23, 28,*

<sup>95</sup> ligjit nr:9902 dt:17.04.2008”Për mbrojtjen e konsumatorëve”indryshuar

rënë dakort dhe kanë nënshkruara kontratën ,por kjo pavlefshmëri e kushtit (ku nëse do të bëjmë një analizë në përputhje me nenin 92 të K.C ku përcaktohet pavlefshmëria absolute e veprimit juridik ku pika a e këtij neni përcakton se kur veprimi juridik është kryer në kundërshtim me ligjin ai do të jete i pavlefshëm ) në rastin konkret duke qënë se kushti është pjesë e një kontrate konsumatore (pra një veprim juridik unilateral)dhe si i tillë ai është në kundërshtim me ligjin si kusht por duke mos prekur vlefshmërinë në tërësi të veprimit juridik mund të arrihet në konkluzionin se natyra juridike e pavlefshmërisë së kushtit është pavlefshmëri absolute për aq kohë sa ai shkon në kundërshtim me ligjin si dhe i lihet lirshmëria konsumatorit për mos zbatimin e këtij kushti,pra evidentimi i kushtit të pavlefshëm është vetëm në nivelin e konstatimit dhe jo në nivelin e investimit të palës element ky që kërkon veprime proceduriale në Gjykatën,e cila vetëm do të kontratoi pavlefshmërinë dhe nuk do të investohet në shqyrtimin nëse kemi apo jo pavlefshmëri të veprimit juridik,në këto kushte duke pasu parasysh efektet e kushtit të padrejtë i cili që të konsiderohet i pavlefshëm në mënyrë absolute duhet që edhe të mos të ketë pasur qëllimin e sjelljes së pasojës së ardhur *de facto* nga elemnti i kushtit të padrejtë pra edhe në elemntin *animus* kërkohet që të mos ekzistoi qëllimi i sjelljes së pasojës ,në këto kushte juridike mund të konsiderohet se kushti ka natyrën e një kushti absolutisht të pavlefshëm.

Por nga ana tjetër a mbetet i vlefshëm juridikisht veprimi juridik,kjo duke pasu parasysh faktin që në përmbajtje verimi juridik mund të jetë i pavlefshëm pasi përmban kushte të cilat janë të padrejta dhe në kundërshtim me ligjin?Pavlefshëria i shtrin efektet vetëm mbi këtë kusht apo edhe mbi të gjithë kontratën si veprim juridik?Në fakt nëse i referohemi nenit 111 të K.C ku përcaktohet pavlefshmëria e pjesshme e veprimit juridik mund të konkludohet se në rastin kur kushti i padrejtë është i “izoluar” pra ai nuk prek pjesët e tjera të kontratës atëher pavlefshmëria do të sanksionohet vetëm për këtë kusht të padrejt por kontrata do të jetë e vlefshme për pjesët e tjera,të njëjtin qëndrim mban edhe ligji për mbrojtje konsumatore në nenin 28 pika 2 ku përcaktohet se”*Në rastin kur kushti konsiderhet i padrejtë ,ai quhet i pavlefshëm nga koha që është lidhur kontrata.Kushtet e tjera kontraktuale mbeten detyruese për palët dhe zbatimi i mëtejshëm i kontratës është i mundshëm*”pra nga ky përcaktim rezulton se kontrata mund të jetë e pavlefshme kjo në rastin kur kushti i padrejtë ka efekte në tërësi në kontratë ,kjo pasi ky kusht mund të ketë efektin “domino” në tërësinë e të drejtave dhe detyrimeve të tjera të tregtarit dhe konsumatorit dhe si e tillë kjo marrdhënie juridike nuk mund të vazhdojë bazuar në një kontratë e cila është në kundërshtim të interesave të konsumatorit.



Arsya se përse ligji ka parashikuar mundësinë e pavlefshmërisë së pjesshme lidhet me qëllimin për të mos cënuar tërësinë e kontratës si një veprim juridik të vlefshëm kjo edhe për të krijuar lehtësira për të dyja palët ,në zëvendësimin nga gjykata të këtij kushti të padrejtë me një kusht të drejtë ,kusht i cili do të lehtësonte respektimin e të drejtave dhe detyrimeve midis palëve në kontratë,por duhet theksuar se ky zëvendësim nuk mund të kryhet kryesisht nga Gjykata por do të duhet që për këtë element të investohen palët me një akt proçedural për të realizuar zëvendësimin e një kushti të padrejtë me një kusht të drejtë ,ç'ka do të kryhet me vendim gjykate.

**KREU III**

**INSTITUCIONET GARANTUSE TË SË DREJTËS SË KONSUMATORIT NË SHQIPËRI**

*3.1.E drejta e ankimit të konsumatorit dhe parashikimi ligjor.*

Mbrojtja konsumatore krahas garantimit ligjor të të drejtave të konsumatorit në një treg ku sistemi ekonomik bazohet te konkurrenca e lirë mes subjekteve në treg, domosdoshmërisht ligji duhej të parashikonte institucionet përkatëse administrative për mbrojtjen e konsumatorit dhe zbatimin e ligjit në praktikë.

Ligji për mbrojtjen konsumatorëe ka parashikuar së në rast të pretendimit të shkeljes së të drejtave konsumatore nga tregtari ,konsumatori ,shoqatat për mbrojtjen e konsumatorëve kanë të drejtën të ushtrojë ankim në institucionet administrative ,ligji përcakton shprehjen “*dhe /ose gjyqësore*”<sup>96</sup>,ligji ka vendosur apriori duke mos kërkuar që qytetari të ezauroi më parë rrugën administrative<sup>97</sup>dhe më pas atë gjyqësore ,por i ka lënë të drejtën e zgjedhjes konsumatorit ose shoqatave për mbrojtjen konsumatore që të përcaktoi pa asnjë pengesë proceduriale se ku do ta drejtoi ankimin në institucionet administrative apo në ato gjyqësor,duke përbërë një përjashtim nga rreguli i përgjithshëm administrativ<sup>98</sup> sipas të cilit çdo subjekt i cili pretendon se i është shkelur një e drejtë duhet paraprakisht të ezauroi ankimit administrativ sikurse është parashikuar edhe në Kodin e ri të Proçedurave Administrative (po ti referohemi renditjes së kontrollit të cilës i nënshtrohet veprimtaria administrative), dhe më pas atë gjyqësorë,kjo për ti dhënë mundësi

---

<sup>96</sup> Neni 55 / 1 I ligjit nr:9902 dt 17.04.2008”Për mbrojtjen e konsumatorëve”i ndryshuar.

<sup>97</sup> Neni 21 I ligjit nr: 44/2015 Kodi I Proçedurave Administrative I Republikës së Shqipërisë”

<sup>98</sup> Sipas nenit 21 të Kodit të ri të Proçedurave Administrative I cili ka hyrë në fuqi më 28.05. 2016 në parimin e kontrollit është përcaktua: “Veprimtaria administrative i nënshtrohet : a) kontrollit administrativ, në përputhje me dispozitat e këtij Kodi mbi mjetet ligjore administrative dhe

- legjislacionit në fuqi;
- b) kontrollit të gjykatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi; dhe/ose
- c) çdo kontrolli tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

subjektit ankimiues që të mund të zgjidh çështjen më shpejt në kohë<sup>99</sup>, si dhe me më pak kosto kjo pasi është fakt i njohur se aksesimi në sistemin gjyqësorë shqiptarë mbart një sërë problemesh kjo për shkak të një sistemi të pakonsoliduar gjyqësor, arsye për të cilën edhe ankimi administrativ është një mënyrë ligjore për të realizuar respektimin e të drejtës në pak kohë dhe me një kosto të ulët.

Por ligji për mbrojtjen e konsumatorit në nenin 55 pika 1 për nga formulimi i dispozitës rezulton se konsumatori ka të drejtën të drejtohet paralelisht institucionit administrativ dhe atij gjyqësor kjo pasi shprehja “dhe /ose” ka krijuar mundësinë e një ankimi paralel ç’ka është në shkelje të parimit të hierarkisë institucionale, por gjithashtu krijon një situatë të vështirë procedurale kjo pasi mund të kemi paralelisht dy vendime si nga institucionet administrative ashtu edhe vendime gjyqësore paralele për të njëjtën çështje, praktikë që është kundër ligjit procedural, Kodi I Procedurave Administrative<sup>100</sup>, kjo pasi në këtë situatë subjekti edhe proceduralisht e ka të paqartë procesin e ankimit, një situatë juridike ku mund të zhvillohen dy procese paralele për të njëjtën çështje me të njëjtat palë proceduralisht nuk mund të legjitimohet arsye për të cilën edhe lind nevojshmëria për amendim të kësaj dispozite, duke harmonizuar me legjislacionin procedural në fuqi.

Nga ana tjetër edhe pse Kodi i Procedurave Administrative e ka vendosur në parim respektimin e ankimit administrativ dhe më pas të atij gjyqësorë, kjo në interes të ankimiuesit, edhe në këtë rast ligji me lidhëzën “ose” ka vendosur që konsumatori të zgjedh mes institucioneve administrative “ose” atyre gjyqësore për mbrojtjen e të drejtës duke mos vendosur detyrimin e respektimit të ankimit administrativ dhe më pas atij gjyqësorë por duke ja lënë në dorë konsumatorit të drejtën për të zgjedhur se cila procedurë do të shqyrtojë çështjen, edhe pse procesi

---

<sup>99</sup> Pasi nga praktika gjyqësore është mëse i qartë fakti që proceset gjyqësore zgjasin në kohë, dhe shpesh e japin vendimin në shkelje të parimit kushtetues të respektimit të një afati të arsyeshëm në dhënien e vendimit, çka përbën një praktikë e cila çënon të drejtat e ankimiuesit I cili mund të presë kohë të gjatë për fitimin e të drejtës në praktikë kjo e ndjekur nga sistemi gjyqësorë shqiptarë e cila shpesh është bërë objekt studimesh dhe diskutimesh në nivel ndërkombëtarë, si dhe për këtë çështje edhe GJEDNJ ka ndëshkuar jo në pakë raste shtetin shqiptarë për shkak se gjykatat kanë dhënë vendime në shkelje të afateve të arsyeshme-vendimet-Çështja Xheraj kundër Shqipërisë, 1.12.2008-Çështja Neumeister kundër Austrisë, Datë 27 Qershor 1968.-Çështja Eemhoff kundër Gjermanisë, Datë 27 Qershor 1968.

<sup>100</sup> Neni 21 I ligjit nr: 44/2015 Kodi I Procedurave Administrative I Republikës së Shqipërisë”

administrative garanton mbrojtjen më efikente të së drejtës konsumatore ,duke kursyer si kohë ashtu edhe kosto te konsumatori.

### *3.2.Institucionet garantuse të së drejtës së konsumatorit ,dhe praktika e tyre.*

Ligji për mbrojtjen e konsumatorit ka përcaktuar një sër institucioneesh administrative ku mund që konsumatori të ushtrojë të drejtën e ankimit konkretisht neni 56 pika i përcakton se konsumatori ka të drejtën e paraqitjes së ankesës te:

- struktur administrative shtetërorë përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve;
- shoqatat e konsumatorëve;
- Avokat i popullit
- Gjykata e Arbitrazhit;
- Organet gjyqesore;
- Çdo strukturë tjetër,e krijuar posaçërisht për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjyqësorit.

Nga tërësia e institucioneve të përcaktuara në këtë dispozitë për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtës së konsumatorit institucioni i cili në bazë të ligjit ka të drejtën të aplikoi masa shtënguese kundrejtë tregtarëve për shkelje të së drejtës konsumatore është Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve ,struktur administrative kjo e përcaktuar me kompetenca <sup>101</sup> të qarta ligjore për marrjen e masave administrative<sup>102</sup> të nevojshme për çdo shkelje konsumatore.

Komisioni i mbrojtjes së konsumatorit është institucioni administrativ i cili garanton mbrojtjen administrative të konsumatorit si dhe mbikqyrë zbatimin e ligjit për mbrojtjen e konsumatorit nga shkeljet e të drejtave të tij nga tregtarët institucion i cili ka të drejtë të mund të shfuqizojë kushtin e pretenduar si të padrejtë dhe të detyrojë tregtarët të marrin masa për respektimin e ligjit në kontratën konsumatore,kjo gjithmon kur ka kundërvajtje administrative ,kjo pasi shkelja e të drejtave të konsumatorit nuk konsiderohet si vepër penale.

### *3.3.Veprimtaria e Komisionit të mbrojtjes së konsumatorit në raport me kushtin e padrejtë.*

---

<sup>101</sup> Neni 49/2 i ligjit nr:9902 dt 17.04.2008”Për mbrojtjen e konsumatorëve”i ndryshuar

<sup>102</sup> Neni 57 i ligjit nr:9902 dt 17.04.2008”Për mbrojtjen e konsumatorëve”i ndryshuar

Komisioni i mbrojtjes së konsumatorit ka një praktikë të gjerë në marrjen e masave shtënguse për tregtarët të cilët aplikojnë kushte të padrejta në kontratat konsumatore një sër vendimesh janë dhënë për kontratat në sektorin bankarë ku edhe abuzimi me të drejtën konsumatore si dhe aplikim i kushteve të padrejta shpesh ka rezultuar me sanksione ndaj bankave por edhe kanë qënë shkas për amendimin e ligjit për mbrojtjen konsumatore.

Konkretisht në vendimin nr:33/2014 Komisioni për mbrojtjen e konsumatorit u shpre se në rastin kur furnizuesi i energjisë elektrike nuk ka njoftuar më parë konsumatorin me shkrim rreth ndërprerjes së kontratës së energjisë elektrike ,kjo përbën mospërmbushje të detyrimit të furnizuesit për të dhënë informacion të plotë konsumatorëve ,gjithashtu është parashikuar në kontratë se detyrimi për likuidim i konsumatorit do të kthehet në kusht për ndërprerje të kontratës së furnizimit kjo duke mos llogaritur dëmin që i vjen konsumatorit kryesisht dëm ekonomik ,këto dispozita kontraktuale u konsideruan si shkaktim i *pabarazisë* së ndjeshme dhe të dallueshme në të drejta dhe detyrime mes furnizuesit me energji dhe konsumatorit kjo me pasojë shkaktim dëmi te konsumatori për këtë shkelje Komisioni kërkoi vetem zbatimin e këtij vendim nga Enti Rregullatorë i Energjisë dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a

Një tjetër rast i konstatimit të kushtit të padrejtë në kontratat konsumatore është edhe vendimi nr:42/2016 ku Komisioni konstatoi mospërmbushjen e detyrimeve ligjore të cilat rrjedhin nga neni 28 i ligjit nr:9902/2008” Për mbrojtjen konsumatore” në këtë rast kompania Abissnet sh.a në hartimin e kontratave me konsumatorin /klient kishte përdorur një shkrim me madhësi karakteri të vogël për pasojë kjo paraqiste vështirësi në leximin e kontratës dhe për pasojë dekurajnte lexueshmërinë e kontratës nga konsumatori çka lehtësonte firmosjen në mirëbesim dhe njëkohësisht në padije të kushteve reale të kontratës.

Kjo është një kërkesë e ligjit për vlerësimin e kushtit të padrejtë edhe pse paraqitet si formale mbart një rëndësi thelbësore pasi kushtet duhet të jenë të qarta nga pikpamja vizive ,leksilogjike ,gramatikore ,sintaksore dhe sematike por gjithashtu edhe nga pikëpamja optike<sup>103</sup>,kriter që ishte shkelut nga operatori ,edhe në këtë rast sanksioni i përcaktuar nga Komisioni ishte zbatimi i vendimit nga operatori Abissnet sh.a.

---

<sup>103</sup> Vendimi nr: 42/2016 i Komisionit për Mbrojtjen e Konsumatorit

Domosdoshmërishtë KMK ka zbatuar në praktikë ligjin por a janë këto masa të mjaftueshme për garantimin e të drejtës së konsumatorit për mbrojtjen kundrejt kushteve të padrejta në kontratat konsumatore? Kjo pasi edhe pse hartohen këto vendime dhe raporte sanksioni edhe pse shkeljet janë me pasoja të rënda për konsumatorët përsëri aplikim vetëm i gjobave sa do të ashpra që të jenë ato përsëri lejojnë mundësinë e aplikimit të kushteve të padrejta, arsye për të cilën do të duhet një amendim për ashërsimin e sanksioneve të cilat ndëshkojnë këto praktika në dëm të konsumatorit.

## KONKULUZIONI DHE REKOMANDIME

Mbrojtja e të drejtave të konsumatorit përkundërt qëllimit të maksimizimit të fitimit të tregtarit krijon kushte të favorshme për shkeljen e të drejtave të tij duke bërë të mundur vendosjen në kontratat konsumatore kushte të cilat çenojnë të drejtat e konsumatorit duke krijuar një pozicion juridik “*inferior*” të konsumatorit në raport me tregtarin ,pikërisht për shmangien e kësaj pozite jo të barabartë të konsumatorit me tregtarin ligji ka krijuar mekanizmin e mbrojtjes së të drejtave të tij përkundërt abuzimit.

Pozita inferior e konsumatorit në legjislacionin komunitar është shmangur de jure pikërisht në saj të Direktivës 93/13/KEE akti ky i cili ka bërë trajtim të detajuar të kushteve në të cilat një konsumator mund të pretendoi shkelje të të drejtave të tij si dhe shpërblim të dëmit,është interesant fakti që Direktiva në këtë kontekst kërkon kuptueshmëri dhe thjeshtësi të terminologjisë të përdorur në kontratë por nuk përcakton kritere si për formën ashtu edhe për madhësinë e shkrimit por vendos vetëm parimin mbi bazën e të cilës do të duhet që të veprohet,kjo duke pasur parasysh edhe faktin që direktiva vetëm përcakton kushte bazë ,më pas detajimi i këtyre parimeve mbetet në tagër të shteteve antare.

Gjithashtu Direktiva i ka dhënë të drejtë konsumatorit të mos zbatoi kushtin pjesëpërbërëse të kontratës kjo në rastin kur ai vetë e konsideron këtë kusht të padrejtë,element ky që i jep një rol aktiv konsumatorit në kontratat konsumatore,duke mos e lënë vetëm në kuadrin zbatues konsumatorin por gjithashtu duke i njohur të drejtën e rrefuzimi të zbatimit,Direktiva ka krijuar kushte për shmangie të procesit të ankimit në strukturat administrative ose ato gjyqësore dhe vendosjes së të drejtës së çenuar nga vetë konsumatori duke rrefuzuar zbatimin e kontratës ,element ky që i jep konsumatorit vetë nga akti komunitar një rol aktiv në kontratë,madje edhe nëse këto kushte janë respektuar nga konsumatori duke i sjellë atij dëm,në këtë rast i jepet e drejta e ankimit për të realizuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar.

Nga ana tjetër tregtari gjithmon prirret që të mund të përcaktoi si Gjykatë për zgjidhjen e konfliktit ,Gjykatën ku ai ka qëndër e tij të aktivitetit ,selin e tij ,kjo duke shkaktuar kosto shtesë dhe

pamundësi objektive për konsumatorin për kërkimin e të drejtës ,është rast tipik ky i përmendur në disa çështje të praktikës së GJED-së edhe në këtë rast Gjykata ka mbajtur qëndrim se duhet të favorizohet e drejta e ankimit të konsumatorit si dhe duhet lehtësuar zbatimi i kësaj të drejte arsye për të cilën edhe Gjykata ka vendosur se këto kushte kontaktuale do të konsiderohen të padrejta dhe për pasojë do të duhet që konsumatori të dëmshpërblehet për efektet e pranisë së këtij kushti kontraktual.

Gjykata në çdo rast të cënimit të të drejtave të konsumatorit si dhe në rastin kur këto të drejta kanë kosto të lartë për konsumatorin apo vërshtirësojnë realizimin e të drejtave proceduriale, këto kushte i ka konsideruar të padrejta dhe ka vendosur edhe masën e dëmshpërblimit kundrejt konsumatorit nga tregtari.

Ndërkohë që në praktikën e brendshme shqiptare institucionale si dhe konsumatore vihet re një pasivitet i theksuar në mbrojtjen e të drejtave që vetë ligji i ka garantuar, konsumatori në Shqipëri has një mungesë të theksuar të informacionit kundrejt produkteve që konsumon dhe për të cilat lidh kontratë ,madje edhe shpesh nuk është i qartë rreth kushteve kontraktuale,duke pasur një mirëbesim të “ekzagjeruar” tek tregtari,nga na tjetër kultura për kërkimin e të drejtës në raport me kontratat konsumatore ,vazhdon të mbetet në kuadër të së drejtës zakonore sidomos në zona ku informimi është objektivisht i vështirë,kjo pasi edhe institucionet administrative të vendosura në zonat urbane dhe rurale nuk garantojnë kushte më minimale të informimit të konsumatorit,kjo sidomos në zonat rurale,ku vazhdo ende të jetë i theksuar pasiviteti konsumatorë në mbrojtje të të drejtave ligjore.

Nga ana tjetër përbën detyrim ligjor transparencë dhe informimi i çdo kushti kontraktual të përcaktura në kontratë,nga ana e tregtarit ,gjithashtu edhe strukturat administrative të vendosura në çdo zonë të vendit duhet të garantojnë informim dhe ndërgjegjësim të konsumatorit rreth të drejtave dhe detyrave të tij dhe tregtarit në raport me kontratat konsumatore kjo duke siguruar që konsumatori të mund të jetë i ndërgjegjësuar për çdo hap ligjor që duhet të ndërmarë si në rast të dëmtimit të shëndetit ,ashtu edhe të dëmit ekonomik të pësuar nga tregtari.

Logjikshëm ligji kërkon zbatimin e parimit të *barazisë* në të drejta dhe detyrime midis palëve në kontratat konsumatore dhe për (këtë sikurse u analizua ) janë ngritur mekanizma institucional për



garantimin e kësaj të drejte duke zbatuar ligjin sidomos në pjesën e sanksioneve të cilat bëjnë të mundur respektimin e parimit civil *restitutio in integrum*.

Aplikim i kushteve të cilat janë të padrejta dhe që çënojnë interesat e konsumatorit në kontratën konsumatore krijon kushtet për mbrojtjen e kësaj të drejte kjo në rrugë institucionale të cilat duhet të garantojnë zbatimin rigoroz të ligjit, në këtë kontekst pra të së drejtës kontraktuale konsumatore çështja e parë që duhet të adresohet në rrugë institucionale është “*liria*” kontraktore, kjo pasi liria kontraktore mbart dy fakte të rëndësishme ,së pari liria për të nënshkruar apo jo një kontratë dhe së dyti dhe liria për të përcaktuar kushtet kontraktuale

Liria kontraktore has vështirësi në zbatimin në praktikë ,kjo pasi është i vërtet fakti i njohur se kushtet e tregut të lirë të ofrojnë shumë mundësi për zhvillimin e kushteve të drejta konkurruese por a ekziston konkurrenca në kushtet kontraktuale?

Vërtet tregtarët kanë të drejtë të hartojnë kontrata konsumatore të cilat janë në interes të tyre dhe garantojnë mbrojtjen e tyre ligjore por a hartoen kushtet kontraktuale në liri të plotë edhe nga konsumatori ,a ekziston mundësia reale për këtë?

Në fakt është e vështirë praktikisht që kontratat të mund të lexohen dhe kuptohen nga konsumatorët në çdo qarkullim civil të sendit kjo pasi vetëm vështirësohet qarkullimi civil,dhe kjo praktikë krijon vonesa të cilat kërkohet që të shmangen nga të dyja palët,gjithashtu shkalla e vështirësisë rritet edhe në rastin kur këto kontrata nuk janë *transparente* dhe vështirësojnë edhe procesin e marrjes djeni të konsumatorit rreth kushteve të saj, kjo pasi nëse kushtet ligjore të transparencës <sup>104</sup> nuk janë respektuar efekti do të jetë thejsht një veprim juridik “*fictiv*”kjo pasi konsumatori ka firmosur në padije të kushteve kontraktuale,kjo pikërisht për të siguruar “lehtësirat” në qarkullimin civil të mallit ose shërbimit por që efektet e të cili janë të pa parashikushme dhe të padëshirueshme për konsumatorin

Në këto kushte është e domosdoshme që çdo kontratë konsumatore ti nënshtrohët kushteve dhe kritereve ligjore të transparencës dhe informimit të konsumatorit si për të drejtat ashtu edhe për detyrimet që mbart firmosja e kontratës ,kjo dhe për të shmangur sanksionet ligjore përkundrejt

---

<sup>104</sup> Neni 28 i ligjit nr:9902 dt:17.04.2008”Për mbrojtjen e konsumatorëve”i ndryshuar.

tregtarit i cili domosdoshmërisht do të dëmshpërblejë konsumatorin për aplikim të kushteve të padrejta me pasojë dëmin e konsumatorit.

Gjithashtu është e domosdoshme që ligji të mund të vendos një kufi minimal të arsyshëm të madhësisë së karakterit të shkrimit dhe jo ta lërë atë në kushte referuse “*të paktën 10*”<sup>105</sup>gjithashtu kjo duhet ti përshtatet optikës minimale të shumicës së qytetarëve ,dhe të respektoi formën e shkrimit që duhet të jetë detyrimisht “Times New Roma”.

Ligji ka përcaktuar se kushti kontraktual nuk duhet të jetë negociuar veçmas ,po në rastin kur kushti mund të jetë negociuar veçmas por gjatë negociimit transparencë nuk ka qenë e plotë a do të përbëj shkak për konsiderimin e kushtit të padrejtë edhe pse ai mund të jetë negociuar veçmas (dhe për këtë janë mbajtur akte provuse) por në fazën e negociimit transparencë nuk ka qenë e plotë,pra a duhet transparencë vetëm në aspektin viziv kontraktual apo duhet të jetë element kryesor edhe në fazën negociuse të kushteve kontraktuale?

Domosdoshmëria për të pasur transparencë në negociimin e kushtit të padrejtë është me rëndësi thelbësore kjo pasi realizon procesin e informimit të plotë të konsumatorit rreth tërësisë së kushteve si dhe kushtit që mund të sjell efekte negative te konsumatori por sidoms për këtë kusht kërkohet transparencë e plotë edhe në fazën negociuse ,pasi është e pamjaftueshme vetëm shprehja *negocim* ,duhet që edhe në këtë fazë transparencë të jetë e plotë kjo për të siguruar respektimin e të drejtave të konsumatorit.

Gjithashtu kërkesa për pabarazi të *ndjeshmë* dhe të *dallueshme* kjo për të vlerësuar kushtin e padrejtë referohet pikërisht një krahasimi të gjëndjes së konsumatorit përpara dhe pas firmosjes së kontratës e cila ka sjellë një dëm konsumatorit ,domosdoshmërisht që analiza do të realizohet për të evidentuar dëmin ,por termi i ndjeshëm dhe i dallueshëm ,mbetën terma subjektiv dhe jo të mirpërkufizuar se kur pabarazia është e ndjeshme dhe kur është e dallueshme?Në këtë rast edhe mungesa e një praktike gjyqësore përbën shkak për mos qartësimin e këtyre dy termave ligjorë çka duhet të ishte realizuar në nenin 3 të ligjit,kjo pasi paqartësia përbën shkak për abuzim,arsye për

---

<sup>105</sup> Neni 28 i ligjit nr:9902 dt:17.04.2008”Për mbrojtjen e konsumatorëve”i ndryshuar.

të cilën duhet që ligji të mund të amendohet kjo për të garantuar qartësinë terminologjike të ligjit gjithashtu për të lehtësuar sidomos zbatimin e tij.

Pra që këto garanci ligjore të mund të jene eficente kërkohet që ato të jene të qarta dhe të zbatueshme “*a litera*” nga çdo institucion administrative por edhe gjyqsor edhe pse duhet theksuar se praktika gjyqsore është e pamjaftushme për të bërë të ndjeshme dhe të zbatueshme ligjin për mbrojtjen e konsumatorit.

Nga analiza jo shteruse e praktikës së institucionit ligjorë i ngarkuar për garantimin në praktikë të ligjit për mbrojtjen e konsumatorit Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorit ajo që vihet re nga analiza e vendimeve të cilat janë ndërmarre nga ky institucion të bënë përshypje fakti i mos aplikimit në shumicën e rasteve të masave të *gjobës* kundrejt subjekteve tregtarë operues në treg, kjo është një praktikë që nuk ndihmon zbatimin e ligjit për mbrojtjen e konsumatorit ,gjithashtu dëmton konsumatorin kjo pasi e ekspozon kundrejt shkeljeve të vazhdueshme të të drejtave të tyre duke “toleruar” aplikimin e kushteve të padrejta në kontratat konsumatore.

Është e domosdoshme që ligji të mund të zbatohet ashtu siç është i shprehur me tërësinë e sanksioneve të tij kjo për të garantuar mbrojtjen e kësaj të drejte ,nga ana tjetër masat e gjobave të përmëndura në ligj<sup>106</sup> për aplikimin e kushteve të padrejta në kontratat konsumatore janë sanksione të cilat duhet të shkojnë në proporcion me dëmin e shkaktura pra kërkohet një ashpërsim i këtyre sanksioneve kjo pasi vetëm për nga natyra juridike kundërvajtja administrative synon vetëm ndëshkimin e shkelësit ,i cili e shlyen gjobën edhe mund më pas të evidentoi mënyra më të vështira për përfshirjen e kushteve të padrejta ,në këto raste kundërvajtja administrative nuk duhet vetëm të mjaftohet me vendosjen e gjobës por gjithashtu edhe me shpërblimin e dëmit që i është shkaktuar konsumatorit element të cilin në praktikën e KMK-re e gjejmë me vështirësi.

Nga ana tjetër edhe roli aktiv i konsumatorit do të shërbente në mbrojtjen e të drejtave të tij ligjore gjithashtu në garantimin e mirëzbatimit të ligjit si dhe në përmirësimin e vetë ligjit për mbrojtjen konsumatore, kjo pasi nëse vetë konsumatori i cili preket direkt nga kushtet e padrejta nuk reagon

---

<sup>106</sup> Neni 57/2/b i ligjit nr:9902 dt:17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” i ndryshuar.

dhe mban një qëndrim pasiv kundrejt të drejtave të tij ,edhe pse ligji i garanton këto të drejta edhe pse institucionet janë të pranishme dhe të gatshme në rastin më të mirë për të zbatuar ligjin dhe *ratio legis* në rast të mungesës së një ankimi ,dhe të konsumatorit të qënit aktiv në mbrojtjen e të drejtave të tij,asnjë ligj apo institucion nuk mund të dëmshpërblejë konsumatorin nëse mentaliteti i tij ka në vëmendje të drejtën zakonore ,dhe pasivitetin në mungesën e vullnetit për të mbrojtur vetëveteten nga shkelja e të drejtës dhe nga përfitimi i padrejtë i tregtarit,arsye për të cilën sikurse u theksua edhe më lartë kërkohet një konsumator aktiv jo vetëm për të mbrojtur të drejtën e tij ,por edhe për të përmirsuar sistemin institucional,si dhe plotësimin e hapsirave ligjore ,të cilat shpesh janë hapsira për shkeljen e tij.

## **BIBLIOGRAFIA**

### **AKTET E LEGJISLACIONIT TË BRENDESHËM**

Kushtetuta-1998

Kodi Civil, 1994, i ndryshuar

Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë

Ligji nr:9902 dt:17.01.2008”Për mbrojtjen e konsumatorëve”i ndryshuar;

Ligji nr:9135 dt:11.09.2003”Për mbrojtjen e konsumatorëve” i shfuqizuar

Ligjit nr: 44/2015 “Kodi Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”

Ligji nr. 8192, datë 06.02.1997 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”

Ligji nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”

Ligji nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar .

Marrëveshja për stabilizim asocimin midis Bashkimit Euroipa dhe Republikës së Shqipërisë”  
01.04.2009.

### **LITERATURË VENDASE**

-Tutulani-Semini, Mariana “E drejta e detyrimeve dhe e kontratave pjesa e përgjithshme dhe e posaçme”. Tiranë: Skanderbeg Books, 2006.

-Mariana Dr. Tutlani-Semini “E drejta e detyrimeve dhe e kontratave” Tiranë, 2006

- Mandro Dr. Arta “E drejta romake“ Emal, Tiranë, 2011.
- Nuni, Ardian. Mustafa, Ilir. E drejta e detyrimeve Vol. I e II. Tiranë: SHBLU, 2008.
- Galvano, Francesco. E Drejta private. Tiranë: Luarasi, 2006.
  
- M. Semini; “E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave” volumi I dhe II. Shtëpia botuese “Afërdita, Tirane 1988, Shtëpia botuese “ Scanderbeg book” Tiranë 2007.
- Avni Shehu; “Pronësia” Shtëpia botuese e Librit Universitar, Tirane 1998
- Kodi Civil i vitit 1929 Kodi Civil i vitit 1981.Pasuritë e paluajtshme” Vol.1 dhe II, Shtëpia botuese “ ALBAL” Tirane 1996
- Mehedi J.Hetemi; Detyrimet dhe kontratat”, Shtëpia botuese “Luarasi” 1998 “Obligimet dhe kontratat e përgjithshme”, Shtëpia botuese “ Luarasi” Botuar sipas origjinalit 1932.
- Aliqivadh Lamani, “Procedura Civile e Shqipërisë”, 1962,
- Mariana Semini; “E Drejtë Civile. Pjesa e Përgjithshme.Subjektet” Fakulteti i Drejtësisë“Justicia” Tirane 2004
- Valentina Kondili “E Drejte e Pronësisë” Tiranë, 2007
- Ardian Nuni “E Drejte e Pronësisë” Tiranë,
- J. Latifi “ E Drejte Civile” Tirane
- Valentina Kondili “E Drejte Civile. Pjesa e përgjithshme” Tiranë, 2007
- Bashkim Dr Selmani & Bekim Mr. Rexhepi “E drejta familjare dhe trashëgimore (romake) dhe ndikimi i saj në të drejtën bashkëkohore shqiptare”-Ferizaj, 2014.
- Legjislacioni për mbrojtjen e konsumatorit- Shpjegues për praktikat e padrejta tregtare
- Shpjegues për kushtet e padrejta në kontrata-Tiranë 2015.
- Strategjia Evropiane e Politikës së Konsumatoreve BE 2002-2006;
- Bashkim Dr. Selmani “E DREJTA ROMAKE dhe ndikimi i saj në sistemet e së drejtës bashkëkohore“ Botues: Universiteti Shtetëror i Tetovës. Tetovë, 2013.

## **AKTE NDËRKOMBËTARE**

- Traktati i Maastrichtit, 07 shkurt 1992

-Traktati i Amsterdami, 2 Tetor 1997

-Traktati i Lisbonës, 13 Dhjetor 2007

-Traktati mbi Funkcionimin e Bashkimit European , 01 Dhjetor 2009

-Direktiva 93/13/CEE “Mbi Kushtet e Padrejta”, datë 05.04.1993

-Direktiva 2005/29/CE “Në lidhje me praktikat e padrejta tregtare”,

-Direktiva 2011/83/UE “Mbi të drejtat e konsumatorëve”,

Direktiva 2009/22/EC “Mbi vendimet administrative dhe gjyqësore për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve”

## **VENDIME TË GJED**

-Unicaja Banco SA kundër José Hidalgo Rueda C-482/13, dhe Alii,

-Caixabank SA kundër Manuel María Rueda Ledesma dhe Alii. C-484/13

-Banco Español de Credito , C-618/10-30 maj 2013,

-Asbeek Brusse dhe de Man Garabito , C-488/11,21 Janar 2015,

-Unicaja Banco dhe Caixabank , C-482/13

-BANCO Español de Credito , C-618/10, 21 Janar 2015,

-Unicaja Banco dhe Caixabank , C-482/13

-Banco Primus SA kundër Jesús Gutiérrez García- C-421/14

-Alvarez C-226/12 ,16 January 2014

-Xheraj kundër shqipërise 1.12.2008

-Neumeister kundër Austrisë, Datë 27 Qershor 1968.

-Wemhoff kundër Gjermanisë, Datë 27 Qershor 1968.

## VENDIME TË KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE

-Vendimi nr: 42/2016 i Komisionit për Mbrojtjen e Konsumatorit

-Vendim nr:43/2016 i Komisionit për Mbrojtjen e Konsumatorit

## LITERATURE E HUAJ

-C. CASTRONOVO, “Introduzione”, in “Principi di diritto europeo dei contratti”, Milano, 2001

-The Scope of the Directive- Non-negotiated Terms in Consumer Contracts -2012.

-Thomas Whilhelmsson, Professor at the University of Helsinki-2015.

-Unfair contract terms guidance- Guidance for the Unfair Terms in Consumer Contracts-

-Regulations-1999-September-2008

-The Unfair Terms in Consumer Contracts Regulations-Research Paper 96/93-15 ,October-2006.London-UK.

-Consumer protection, Competition and markets authority-UK-2015.

-Unfair Terms in Consumer Contracts, Standing Committee on Law and Justice, NSW-September 2010.

- “When the state harms competition-the role for competition law “.-Eleonor M. FOX, Deborah HEALEY(2011)

-HOWELLS- The Rise of European Consumer Law— Whither National Consumer Law?- Lancaster Law School, United Kingdom.-2013

-Office of Fair Trading press notice, "Fair terms in consumer contract - new powers come into effect",

-A.G Eze (Mrs.) LL.B, B.L, LL.M Lecturer, Faculty of Law, Nnamdi Azikiwe University, BW. Harvey & D.L Parry; The Law of Consumer Protection and Fair Trading ,London-1996

-The Unfair Contract Terms Regulatory Guide- Jun 2017



-Unfair Terms in Consumer Contracts: Advice to the Department for -Business, Innovation and Skills –March 2013.

#### **INFORMACION ON LINE**

[http://www.pierre-legrand.com/customs\\_brokers\\_v\\_udt.pdf](http://www.pierre-legrand.com/customs_brokers_v_udt.pdf)

[http://ec.europa.eu/consumers/empowerment/docs/eccg\\_opinion\\_consumers\\_vulnerability\\_](http://ec.europa.eu/consumers/empowerment/docs/eccg_opinion_consumers_vulnerability_)

<https://www.jfklibrary.org/JFK/Historic-Speeches.aspx>

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:61997CJ0237:IT:HTML>

[http://ec.europa.eu/consumers/empowerment/docs/eccg\\_opinion\\_consumers\\_vulnerability\\_022013\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/consumers/empowerment/docs/eccg_opinion_consumers_vulnerability_022013_en.pdf)

<http://geography.about.com/od/historyofgeography/a/grandtour.htm>

[http://www.giudicedipace.it/programma/readarticle.php?article\\_id=474](http://www.giudicedipace.it/programma/readarticle.php?article_id=474)

<http://www.legalionline.com/html/consuma.html>

<http://curia.europa.eu/juris/liste.jsf?language=en&num=C-400/00>

<http://www.agcm.it/>

<http://www.iap.it/it/final.htm>

[http://www.personaedanno.it/index.php?option=com\\_content&view=article&id=20420&catid=92&Itemid=339&contentid=0&mese=02&anno=2003](http://www.personaedanno.it/index.php?option=com_content&view=article&id=20420&catid=92&Itemid=339&contentid=0&mese=02&anno=2003)

[http://lawcommission.justice.gov.uk/areas/unfair\\_terms\\_in\\_contracts.htm](http://lawcommission.justice.gov.uk/areas/unfair_terms_in_contracts.htm)

<http://www.scotlawcom.gov.u>

